

BIBLIOTEKA

E

SHTETIT

GJIROKASTER

ÇAJUPI

Memëdhen





8JH-1

A. Z. ÇAJUPI

15

MËMËDHEU

(Vjersha dhe përralla)

— Për fëmijët e moshës së ré dhe të mesme shkollore —

Zgjedhur dhe redaktuar nga:
BEDRI DEDJA e NASHO JORGAQI



N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»

TIRANË, 1958



A. Z. ÇAJUPI



TË DASHUR LEXONJËS TË VEGJËL

Në këtë vëllim ju do të takoheni edhe një herë me Çajupin, poetin tonë të çquar të Rilindjes, i cili ka shkruar edhe për ju të vegjëlit shumë vjersha e përralla të bukura. U them se do të takoheni edhe një herë me Çajupin se pas çlirimit, janë botuar edhe dy vëllime të tjera. Unë u them sot juve kështu, nesër kur të rriteni ju do t'u thoni të tjerëve se vetëm pas çlirimit u hap rruga që shkrimtarët e çquar të njihen nga të gjithë e me vjershat dhe shkrimet e tyre të rriten për të mirën e popullit dhe t'atdheut.

Ju e dini se Çajupi — Andon Zako — ka botuar vëllimin me vjersha me titullin «Baba Tomorri». Nga dashuria e madhe që kishte Çajupi për atdheun e tij s'kishte se si të gjente një titull më të bukur. Tomori është midis Shqipërisë një mal i lartë dhe madhështor, i bukur e me dëborë, që shkëlqen nga rrezet e diellit. Edhe të parët tanë e kanë nderuar këtë mal, që u ka ngjallur gjithmonë dashuri të flaktë për atdhenë.

Çajupi, duke jetuar në kohra të vështira për

Shqipërinë dhe shqiptarët, kur pushtonjësit turqë përpiqeshin t'i zhduknin dhe t'i skllavëronin për jetë, i këndoi dashurisë s'atdheut për të ngjallur tek shqiptarët ndjenja të larta atdhe-dashurie e t'i armatoste në luftë kundër turqve. Ai, duke jetuar në mërgim, larg Shqipërisë, i këndoi me mall fshatit dhe bukurive të Shqipërisë.

Ju do t'i lexoni vet dhe do t'u pëlqejnë kaq shumë, sa që do t'i mësoni edhe përmëndësh vjershat e bukura «Baba Tomori», «Mëmëdheu», «Shqipëtarët», «Ku kemi lerë» e të tjera. Në këto vjersha Çajupi me fjalë të thjeshta, por të ngrohta si zëmëra e poetëve, ka treguar se sa shumë e ka dashur atdhenë, ky bashkatdhetari i ynë, që vdiq me zëmër të zhuritur larg në dhe të Egjiptit. Këto vjersha atdhetare na mësojnë se sa i shtrenjtë është atdheu, ose si e kishin zakon t'i thoshin shqiptarët në kohën e Rilindjes, mëmëdheu. Duke lexuar këto vjersha pyetni pleqt dhe do t'u tregojnë se si i mësonin ahëre këto vjersha, «Trimi i Shqipërisë», «Dëshirë e Skënderbeut ditën që vdiq» dhe se si ndizeshin flakë për lirinë e atdheut në luftë kundra turqëve. Ata do t'u tregojnë se «Sulltani» i Turqisë ka qënë ashtu gjakpirës si e ka përshkruar Çajupi. Këto vjersha rrojnë edhe sot në zëmërat tona dhe ne mburemi se si të parët tonë kanë luftuar kundër të huajve.

Vjershat e bukura «Ku kemi lerë» e «Shqipëtarët» i këndonin në male edhe partizanët trima kur lëftonin kundër fashizmit.

Çajupi ka qënë një mëmdhetar — të themi edhe ne si thoshin atëhere për patriot — i flak-të. Ai deshi një Shqipëri të lirë dhe të lumtur si po e gëzojmë ne sot. Ai deshi t'i edukonte shqiptarët me një moral dhe edukatë të lartë, që të mbretëronte midis njerëzve drejtësia, të flaknin djallëzinë, gënjeshtren, mëndjemadhësinë, që të nderonin punën. Me një fjalë ai u mundua të na mësojë neve virtytet dhe të lëftojë veset.

Do ta shikoni se sa mirë e ka kryer Çajupi këtë detyrë me përrallat e bukura që ka krijuar vet ose që i ka punuar ashtu si vjershëtori francez La Fonten.

Në këtë vëllim ju do të gjeni mbi nëntëdhjetë përralla.

Të gjitha ato janë të bukura, njëra më e mirë se tjetra.

Që t'u them unë në këtë parathënie se ç'duan të thonë këto përralla do të bëja një punë të pa drejtë, se do t'u hiqnja të drejtën tuaj që të përpiqeni vetë. Ca do t'i kuptoni vetë se keni edhe ju një çikë përvojë. S'do ndonjë mundim të madh që përrallën «Xinxuri dhe melingona» që ta kupëtoni. A nuk është tamam kjo përrallë kundër parazitëve dhe dembelëve: kush punon ka të drejtë të hajë. Si thoni ju nuk është turp që një nxënës të mos mësojë mësimet dhe në provimet të gjendet në hall të keq, si xinxuri në dimër? Kështu edhe për mjaft përralla të tjera.

Këto përralla do t'u mësojnë më së miri që të njihni virtytet dhe veset. Kështu që duke

i lexuar dhe duke i pasur parasysh në jetë ju do të bëheni me të vërtetë qytetarë të mirë.

Sigurisht ju e dini jetën e Çajupit. Me gjithë këtë desha t'u them edhe unë disa fjalë, që ta kini bashkë me këtë libër e ta kujtoni përherë.

Çajupi lindi në katundin Sheper të Zagorisë së Gjirokastrës në vitin 1866 dhe vdiq në Egjypt më 1930. Gjithë kohën e ka shkruar në mërgim. U muar me punë për lirinë e Shqipërisë si një patriot i çquar me vjersha, drama e shkrime të tjera. Veprën e tij «Baba Tomori» e botoi më 1902. Që t'u flas unë për ndjenjat e tij patriotike është e tepërt. Ai e ka shprehur vetë se përse e boton «Baba Tomorin»: këto vjersha «janë prej zëmër shqipëtari, shkruar pa ndonjë qëllim tjetër përveç dëshirës për mëmëdhënë dhe shqipen». Pastaj ai na porositi edhe neve: «Cilido mëmëdhetar duhet të punojë sa t'i ipehtë... Kush pak, kush shumë, po është nevojë të punojmë të gjithë për Shqipërinë». Vetëm këto fjalë na tregojnë jetën e Çajupit.

Ai u zhurit që ishte larg mëmëdheut dhe sa keq, do t'u vijë shumë likshtë e di, se si thonë, në pleqëri, pasi i vdiq gruaja edhe djali, mbetur vetëm, u verbua nga të dy sytë.

Po nuk qe e thënë që eshtrat e Çajupit të mbeteshin përgjithëmonë larg atdheut. Partia e jonë, që i do dhe i çmon shumë patriotët, me një vendim që mori, në korrik të vitit 1958 eshtrat e Çajupit i prunë në Shqipëri.

Ku më duket balta
M'e ëmbël se mjalta
Në Shqipëri!

Kështu kishte kënduar Çajupi afro gjashtëdhjetë vjet më parë; këto vargje kujtuan të gjithë shqipëtarët më 11 korrik 1958 atë ditë që si mizë lisi kishin grahur atje te «Bregu i Bajos» në qytetin e Gjirokastrës për të vendosur eshtrat e Çajupit, poetit tonë të dashur; Çajupit tonë, që më në fund gjeti prehjen e dëshiruar në Shqipërinë e çliruar, pa bejlerë e agallarë, pa çfrytëzonjës e pa të huaj.

Çajupi në vjershën «Për çunat shqipëtarë», që e keni në këtë vëllim, u lutet çunave që këto vjersha:

... të mos përtojnë
Po të rrinë, t'i këndojnë.

Tani ç'far tu them unë, kur vet Çajupi ju lutet?

Zihni Sako



I. ATDHEU

1. BABA-TOMORRI 1)

Baba-Tomorr, Kish' e Shqipërisë
mal i lartë, fron i Perëndisë,
tek Ti vinin njerzitë qëmoti
për të msuar se ç'urdhëron Zoti ...
Tek Të lutem dhe u'duke qarë
të msoj ç'thotë dhe për Shqipëtarë
Kanë qënë trima të lëvduar
dhe në luftë s'janë turpëruar;
qenë trima dhe mëmëdhetarë,
besa, fea s'i kishnë dhe ndarë,
shkonin jetën me puçkë në dorë,
donin shqipen, s'qenë tradhëtorë;
lulëzonte gjithë Shqipëria,
s'e kish shkëlur si sot Robëria;
gra e burra donin Shqipërinë,
djem e çupa këndonin Lirinë.
Sot qysh gjendet Komb' i Shqipërisë!

1) Poeti krijon në këtë vjershë figurën poetike të malit Tomorr, të cilin patriotët tanë të rilindjes e quanin mal të shënjtë.

I përmbysur nga zgjedh' e Turqisë.
 Shqipëtarët, si dhe bakëtia,
 cbathur, çveshur, vdesën nga uria!
 Shqipëtarët? — Sot s'ka Shqipëtarë! ¹⁾
 Turku, Greku na kanë përndarë!
 Prifti, hoxha, kisha dhe xhamia,
 na gënjejnë.... U prish Shqipëria!...
 Mal i lartë me krye në diell,
 fron i Zotit q'është mbret në qiell,
 Baba-Tomorr, o mal i uruar,
 ç'kanë gjarë, gjithë ç'kanë shkuar,
 i di vetë s'duet të T'i themi;
 ç'do të ngjajnë, Të lutem rrëfemi.
 Sot e tutje, ç'thotë Perëndia,
 do të heqë shumë Shqipëria?
 Ç'faj ka bërë, ç'gjynahe paguan?
 Nga Turqia të tërë shpëtuan:
 Greku, Sërbi, Vëlau ²⁾, Bulgari, —
 nënë zgjedhë mbeti Shqipëtari!
 Ç'thotë Zoti për kombinë tënë
 do ta lërë nën Sultan — qënë?
 Na shkrettoi, na preu, na griu
 na mundoi, shpirtinë na nxori!
 Fshiu lotë dhe më tha Tomori:

O Shqipëtarët e gjorë,
 dëgjoni Baba-Tomorrë:
 kombi juaj s'vete mbarë,
 se besët u kanë ndarë.

1) Këtë shprehje, autori e përdor për të treguar sa shumë
 ishin përçarë shqiptarët.

2) vllchët.

Besa e bashkon njerinë,
ju pse ndani Perëndinë?
Si ungjilli dhe Kurani:
nukë na dihetë fundi:
me qiejtë mos u mbani,
se nuk mbahen gjëkund.
Të krishter' e myslimanë
gjithë një Perëndi kanë;
jini një gjak mor' të mjerë,
se ndë një vend kini lerë.
Jini gjithë Shqipëtarë,
s'jini Grekër as Tartarë.
Hiqni dorë nga rreziku,
shihni se ç'punon armiku,
i pabesi dhe i ligu.
Mblidhuni të bëni benë,
të kujtoni Skënderbenë,
të duani mëmëdhenë,
të mos e lini të shkretë.
Ngrihi ta shpëtoni vetë,
se u ndin Zot' i vërtetë.
Mos e peshoni Turqinë,
mos e besoni Morenë
në duani Perëndinë,
të duani mëmëdhenë.
Erdhi dita të luftojmë
për lirin' e Shqipërisë;
ja të vdesëm, ja të rrojmë
si burrat e Trimërisë.

2. MËMËDHEU

Mëmëdhe quetë toka
ku më ka renurë kokā,
ku kam dashur mëm' e atë,
ku më njeh dhe gur' i thatë
ku kam pasurë shtëpinë,
ku kam njojtur Perëndinë,
stërgjyshët ku kanë qenë
dhe varet q'i kanë vënë,
ku jam rritur me thërime,
ku kam folur gjuhën time,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë,
ku rroj me gas e me shpresë,
ku kam dëshirë të vdesë.

3. SHQIPËTAR!

Shqipërin' e mori Turku,
i vu zjarr!
Shqipëtar, mos rri po duku,
Shqipëtar!
Mjaft punove për të tjerë,
o fatkeq!
Kujto vëndë tek ke lerë
dhe tek heq.
Të ka bërë Perëndia
luftëtar,

si s'të lodhi Robëria,
Shqipëtar!
Erdhi dita të ngresh kokë;
të kërkosh
Lirinë, bashkë me shokë
të lëftosh!
Mos bëni si kini bërë
gjer më dje,
po të lëftoni të tërë
për atdhe.
Pesëqint vjetë kemi rruar
me pahir,
lidhurë nga këmb' e duar
me zinxhir!...
Muslyman' e të krishterë
jemi keq!
Të ngrihemi që të tërë,
djem e pleq!
Të ngrihemi të dëftojmë
trimëri;
ja të vdesim, ja të rrojmë
për liri!
O moj Shqipëriz' e dashur,
mëmëdhe,
të shoh me buzë të plasur,
si më she.
U shkretove anëmbanë;
Shqipëri,
se Shqipëtarëtë s'kanë
dashuri.
Gjithë djemtë që ke qarë
dhe mban zi,



për Morenë janë vrarë,
Për Turqi! 1)
Çvish robot e Robërisë,
mëmëdhe,
vish armët e Trimërisë,
se ke ne!

4. KU KEMI LERË

Në ç'vënd kemi lerë?
Ku na bëjnë nderë?
— Në Shqipëri.

Po njeriu vetë,
Cinë do në jetë?
— Do vënd' e ti.

Ku i duket balta
m' ëmbël se mjalta?
— Në Shqipëri.

Ku rron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë?
— Në vënd të ti.

Ku munt të gëzojë
dhe me nder të rrojë?
— Në Shqipëri.

Përse të punojë
dhe të lakmojë?
— Për vënd' e ti.

1) Çajupi këtu e ka fjalën për ata djemë të Shqipërisë, që ranë viktime andej-e-këtej për interesat e shovinstëve grekë dhe për interesat grabitqare të Turqisë.

5. TRIM' I SHQIPËRISË.

Kush ka qënë trim një herë?
Aleksandr' i Math i vjerë,
Pirua me shokë të tjerë
në Shqipëri kanë lerë.
Po nga të gjithë m'i zoti, —
Skënderbeu Kastrioti.
O mbret i dashur ku je?
Ku je, more Skënderbe?
Si duron t'i nënë dhe?
Nukë të vjen keq për ne?
Që ditënë që na le,
vëndi yn' u bë raje! ¹⁾...
Të lutemi, dit' e natë,
n'atë jetë ku ke vatë,
dërgona shpres' e uratë
të mos rrojëmë si gratë...
Të ngrihemi, të lëftojmë,
Turqit këtejë t'i dbojmë;
Shqipërinë ta shpëtojmë
dhe lir' e me nder të rrojëmë.

1) «... vëndi yn' u bë raje...», shkelet me këmbë nga të gjithë dhe nuk ka zot.

6. DËSHIR' E SKËNDERBEUT DITËN QË VDIQ.

Sa rrojta s'u turpëruam:
të gjithë bashkë lëftuam,
vëndinë tën' e nderuam,
se nga Turqit e shpëtuam.
Po tani u afërua
dit' e fundit dhe për mua.
Gjithë këtë ditë presëm,
kemi ler' e do të vdesëm;
njeri për jetë s'ka mbetur,
dheu të gjith' i ka tretur;
po lum kush është përpjekur
dhe për atdhenë ka vdekur.
Ndaj desha, sa jam dhe gjallë,
t'u mbleth t'u them këto fjalë:
O vëllezër Shqipëtarë,
u lutem të bëni mbarë, 1)
gjithë bashk' e të pandarë.
Mysliman' e të krishterë
Perëndia na ka bërë:
jemi vëllezër të tërë,
Zoti kur bëri insanë 2)
me një fytyrë të naltë;
të krishter' e myslimanë
i gatoi nga një baltë.
Zoti me të math të vetë
është një dhe i vërtetë;
si këtu dhe n'atë jetë.

1) «... të bëni mbarë...» — të bëni punë të mbara.

2) njerinë.

Si Ungjilli dhe Kurani,
mos e ndajni Perëndinë;
shoku shoknë mos e hani
si punojn' ata që s'dinë;
besa është e gjithësisë,
ne jemi të Shqipërisë,
se kemi pirë një sisë.
Për Perëndi që besoni,
Shqipërinë mos haroni;
pra faluni si të doni...
Faluni te Perëndia,
të shpëtojë Shqipëria
nga e ndyra Robëria.
Tani ta shpëtoni vetë,
se unë nukë kam jetë,
vete te Zot' i Vërtetë.
Do t'i lutem duke qarë
të jetë me Shqipëtarë
dhe t'u apë dashurinë
të nderojnë Shqipërinë.

7. SULTANI 1)

Jam Sultan, mbret i vërtetë,
shoq të tjerë s'kam në jetë;
gjakëtor e zemërderr,
nga frika më bëjnë nder!
Dola nga fund' i Asisë

1) Sulltan Abdyl Hamiti II (1842-1908).

si rrebesh i Perëndisë:
vrava, preva e shkretova,
botën me gjak e mbulova!
Kur zotova Anadollë,
erdha mora dhe Stambollë,
njerzit i shkova në thikë!
Dhe kush mbeti, rron me frikë! . . .
Jam i keq si egërcirë!
Të urtët janë të mirë:
dua të quem i marrë,
po puna të vejë mbarë.
Thera Grekër e Bullgarë,
thera Ermenët e mjerë, ¹⁾
Egërcirë si ariu,
me fytyrë si njeriu,
më dërgoi Perëndia
që të vuaj' njerëzia!
Evropa që më shëkon,
të më bëjë gjë s'guxon,
se ka mejtime të tjera. . .
Prisha, vrava, preva, thera!
Bëra, . . . po ç'nukë kam bërë?
Prisha botënë të tërë!
Mysliman' e të krishterë
kam dërguar n'atë jetë
më tepër se ç'vdignë vetë!
Jam i zoti, rroj me pallë,
s'dua të shoh njers' të gjallë!
Nat' e ditë gjak kërkoj,
pa pirë gjak s'munt të rroj!

1) Aluzion te masakrat e mëdha t'Ermenëve në dhjetëvjetorin e fundit të shekullit XIX-të.

Dhe tani q'u bëshë plak,
 nukë mund të fryem gjak!
 Ata që kam nënë zgjedhë,
 të mundijë tok t'i mbledhë,
 me dorë time t'i vrasë,
 të pijë gjakn' e rajasë!
 Pse s'u bë nga Perëndia
 me një kokë njerëzia,
 që ta presë menjëherë!
 Të mos mbetëshin të tjerë!
 Të mbetëj dheu i shkretë,
 se dojë të rrojë vetë:
 me egërcira të rrojë,
 pa frikë të mbretërojë,
 se më duan e i dua,
 jemi një gjak e një sua! ¹⁾
 S'lashë njeri pa të keq!
 Gra e burra, djem e pleq,
 dridhenë kur më kujtojnë;
 mëmatë më mallëkojnë,
 më mallëkojnë të vatë ²⁾
 edhe qajnë dit' e natë!
 Qajnë! Po kush nukë qan?
 Qajnë bura, qajnë gra,
 qajnë maletë për pyje,
 qajnë fushatë për lule!...
 Kudo shkela u tha bari!
 Ç'la puçka ³⁾ e dogji zjarri!...
 Egërcirë si ariu,

1) sua = soj, fis.

2) të vatë = gratë e veja.

3) puçka = pushka.

hëngra dhe un' mish njeriu!
Si kam dashur kam punuar,
pse nukë jam i gëzuar?
I lik jam, të liga dua,
nga kush më vjen frikë mua?
Nukë di se ç'kam i ziu,
nga frika gjaku më ngriu. . .
Me punëra që kam bërë,
më duken armiq të tërë,
mysliman' e të krishterë,
sa dhe trimat Shqipëtarë
zun' e më punojnë varrë!
Humba Moren ¹⁾ e Vllahinë, ²⁾
Bullgarinë me Serbinë.
Bosnjënë me Mal' e Zi.
Gjiritnë me Thesali.
Keshë kompn' e Shqipërisë
direk i gjith' Turqisë;
pse s'më priti sa të vdesë
pa të më dil i pabesë!
Me Shqipëri të lëftonem;
kam frikë mos turpëronem;
kam frikë nga Skënderbeu
mos dalë prap nga dheu! . . .
Se ç'mentoj, a ç'jam i marri!
S'më bën dot gjë Shqipëtarë.
Dhe sa të jem vet'i gjallë,
nga zgjedha s'ka për të dalë.
Pas meje në këtë jetë,
guri mbi gurë mos mbetë!

1) Morea = Greqia.

2) Vllahia = Rumania.

8. VAJ.

O Shqipëtarë të mjerë,
ç'u ka marrë koka erë,
derthni gjaknë për të tjerë!
Gjithë trimat e Turqisë
janë djemt e Shqipërisë;
ata që bënë Morenë
gjithë Shqipëtarë qenë.
Lëfton Turku me Junanë ¹⁾
po Shqipëtarëtë ç'kanë,
q'u ngrenë të gjithë e vanë,
ca mënjan' e ca mënjanë?
Mysliman' e të krishterë,
në luftë vanë të tërë;
lanë mëmëdhenë shkretë,
vanë të vriten vetë!
Sos vriten për Shqipërinë,
po për Moren' e Turqinë!
Në bërrul të penxheresë
qan Shqipëtarë pa shpresë:
qan e të këput kaurka,
për karshi qan edhe turka:
që të dyja shqipëtare
qajn' e s'pushojnë fare,
se djemtë në luft' u vranë,
myslimani për Sulltanë,
i krishteri për Junanë,
me njeri-jetër u vranë!...
Mëm' e zezë del në shkallë
qan e ulërin për djalë;
si burim i venë lotë,

1) Aluzion te lufta greko — turke e vitit 1896.

djalitë vetëm i thotë:
«Pse nukë riye tek jeshë?
Turkun e Greknë ç'i keshe?
Sos lëftonte Shqipëria,
që nxive ditët e mia!
Vajte në luft' e më s'erdhe,
S't'erdhi keq për gjak që derdhe?
Sos e derdhe për atdhenë,
po për Turk' e për Morenë!
Si të ta fal marrëzinë, —
sos ¹⁾ vdiqe për Shqipërinë!
Për një derr e për një dhelpër,
Për Sulltan edhe për Grekër
vajt' e humbe këtë jetë,
ike dhe më le të shkretë!
Bir, o bir! u mbyll shtëpia!
U shoft' e tërë Turqia,
u shoftë edhe Grekuria,
mos u gjentë fis e far,
gënjejnë me Shqipëtarë!
Sa mëma që kanë qarë
për djemtë q'u janë vrrarë!
E zeza, që më la djali!
Bir, o bir ç'më mori malli!
Bir, o bir! Ç'punë punove
pleqërinë ma shkretove!
Dajlërin' e trimërinë
s'i humbe për Shqipërinë!
Vajte lëftove për botë,
u mundove, dëm e kotë!
Bir, o djal' i vetëmë;
se ç'më nxive jetënë!»

1) sos = se mos.

9. ROBËRIA

E dashura mëmëdhe,
të dua dhe kshtu si je!
Po kur të të shoh të lirë,
do të të dua më mirë.

Qani pyje, fusha, gurë,
qani male me dëborë!
Shqipëria mbet' e gjorë
dhe nukë sheh dritë kurrë:
një mjergull e keq' e shkretë
e ka mbuluar për jetë!

Një gazep, një errësirë!
Vetëtit' edhe gjëmon!
Rojmë me zemër të ngrirë,
nga frika kërkush s'gëzon!
Njerzitë kurrë s'këndojnë
dhe bilbilëtë vajtojnë!

Qiameti, shkretëtira!
Zogu vete ze folenë,
njeriu le mëmëdhenë
se mbretëron egërsira!
Për Shqipëri dëshërojmë
se në vend të huaj rojmë.

Robërinë si duron,
o moj Shqipëri e mjerë?
Shpëtove vënde të tjerë,
vetë nënë zgjedhë ron!
Shqipëtarë bëni benë
të lëftoni për atdhenë.

E dashura mëmëdhe,
të dua dhe kshtu si je!
Po kur të të shoh të lirë,
do të të dua më mirë.

10. PUNËRAT E PERËNDISË.

Zot i math e i vërtetë,
çdo pun' e ke bërë vetë:
bëre qiejt dhe denë,
bëre yjetë dhe dhenë,
bëre diellin me dritë,
bëre nat' e bëre ditë,
bëre erënë dhe retë,
bëre pemëtë me fletë,
bëre hënëzën me yje,
bëre fusha, male pyje,
bëre zoqtë që këndojnë
dhe lulet që lulëzojnë,
bëre dimër e beharë,
bëre kuaj dhe gomarë,
bëre misër dhe grurë,
po më shumë bëre gurë,
Si bëre kaqë të mira,
bëre dhe shum egërsira;
bëre arinë dhe derrë,
bëre ujqër e të tjerë;
bëre.... Po ç'nukë ke bërë?
Bëre botënë të tërë.
Bëre një djallë me brirë!

Ç'do punë e ke bërë mirë;
po një gjë bërë pa mënde
dhe prishe punën tënde,
kur bërë derr' e arinë
ç'deshe që bërë Turqinë?
Se të mos qënkej kjo farë
bota do të vinte mbarë,
dheu do të lulëzonte,
Shqipëria do t'gëzonte,

11. VARFËRIA DHE LIRIA

Jam i varfër, po i lirë,
ndaj më pëlqen varfëria;
kush do të rrojë më mirë,
s'urdhron dot veten e tia.
Mbreti sikur të më thotë
«Hajde në palas¹⁾ me mua,
të gëzosh dhe ti në botë»,
do t'i them: «Zot, nukë dua.
Për të ngrën' e për të pirë
nukë munt të shesë lirinë;
i varfëri rron më mirë
s'ai që do madhërinë.
S'më duet ërgjëndi mua,
dua lirinë dhe nderë,
dua të bëj si të dua
jo si të duan të tjerë.

1) pallat

Kush munt e bën si do vetë,
bën si thotë Perëndia :
nukë ka në këtë jetë
gjë m' e vyer ¹⁾ se liria».

12. FSHATI IM ²⁾

Maletë me gurë,
fusha me bar shumë,
aratë me grurë,
më tutje një lumë.

Fshati për karshi
me kish' e me varre,
rotull ca shtëpi
të vogëla fare.

Ujë të ftotë,
ëra pun' e madhe,
bilbili ia thotë,
gratë si zorkadhe.

Burat nënë hie,
lozën kuvendojnë; —
pika që s'u bie,
se nga gratë rrojnë!

1) më e shtrejtë, më e vlefshme.

2) Në këtë vjershë Çajupi godet zakonet prapanike të Shqipërisë së asaj kohe e, sidomos përtacinë e burrave, për të cilët punonin gratë.

Gratë venë nd'arë
dhe në vreshta gratë,
gruaja korr barë,
punon dit' e natë.

Gratë në të shirë,
në të vjela gratë,
ikinë pa gdhirë
kthenenë me natë.

Gruaja për burrë
digjetë në diell,
punon e s'rri kurrë
as ditën e diel.

O moj Shqipëtarë
që vet' e nget qetë,
edhe drek' e darkë
kthenej e bën vetë;

moj e mjera grua,
ç'e do burrë zinë,
që ftoet në krua
dhe ti mban shtëpinë!

13. DHEU.

Dheu i gjat' e i gjërë
na jep buk' e na jep verë,
për të ngren' e për të pirë,
kush di ta punojë mirë.

Si një njeri i shtrënguar,
dheu nukë fal gjë kurrë:
pa munduar, pa punuar
s'na jep as misër, as grurë.

Do ta punojë njeriu
dhe ta vadijë ¹⁾ me djersë
që të hajë buk' i ziu
nga uria të mos vdesë!

Punoni, more të mjerë,
se dhe gjëri ne na mbetë,
pas neve vinë të tjerë,
nukë sositë kjo jetë.

1) ta vadisë.



II. PËRRALLA TË VERTETA DHE TË RREME

1 MISIRI

Fushë dhe fushë dhe fushë prapë,
fush' e pasosur dhe shumë vapë
Mal s'të sheh syri, as brek, as gurë,
po gjithëmonë tym' e pëlhurë.
Miza dhe pleshta dhe morra shumë,
kunup' i shkretë të le pa gjumë,
Era e ngrotë, ujëtë trubull ;
fiku me gjëmbe, pjepri si kungull.
Përrenj s'ka fare, vetëm një lumë,
i math si deti, mbulon me shkumë
fushën të tërë, gjithë Misirë.

.

Aratë s'reshten, i vadit Nili :
tek korret gruri ; mbillet tërfili,
elbi dhe misri, thekra, pambuku
dhe dëm e kotë s'mundonet bujku
Qetë si buaj, qeni si ujku
Pyll s'sheh dot kurrë, as re në qiell

Fshatratë xhveshur digjen në diell
Udhët plot çuna, koshet plot mjaltë
shtëpit' kasolle bërë me baltë,
lyer me bajga brenda dhe jashtë,
janë mbuluar me dru dhe kashtë.
Kuj të mirë dhe të lëvduar
gomarë shumë dhe të dëgjuar.

Behari furrë, dimri si vera,
bashkë kullosin dhentë me derra.
Shumë të pasur e të papunë
në dimër vinë, rrinë këtunë.
Nëpër qytete, nga minaretë,
noxhët pëllasin me zë si qetë.
Njerstë betohen për Muhamenë
dhe kur i falen puthinë dhenë
Udhëtë shtruar me gur si shtufë,
njerzitë venë, vinë si tufë,
zbathur dhe zveshur dhe të ngarkuar,
po parësia m'umbrell në duar,
dhe grat' e tyre dalën mbuluar.
Vdes njeri? Gratë zen' e vajtojnë,
qajn' ulërijnë sikur këndojnë.
Këtu ka prinsë dhe pashallarë
bejler' më tepër se nga gomarë;
të pasur shumë sa s'dinë ç'kanë
po më të shumtë s'kanë të hanë.
Përmi të gjithë, një Efendinë ¹⁾
qeveris vëndë nënë Anglinë.

1) Khedivi, zëvendës mbreti i Misrit.

2. KORBI DHE DHELPRA

Zoti korb një ditë, me djathë në gojë,
në një degë lisi vate të qëndrojë. .
Nënë lis një dhelpër korbin e kish parë,
i ra erë djathi dhe kërkon t'ja marrë.
«Fatmirosh më qënke! — thotë zonja dhelpër, —
Bukurinë tënde nuk e ka zok tjetër!
Pëndë të floriyta, sikundër i doje!
Të keshe dhe zënë, do të mbretëroje!»
Të rrëfejë zënë, zoti korb gërhati,
djathët ra nga qefti, dhelpëra e priti. . .
Si dhelpra, Turqia qesh me Shqipërinë:
kur na ka nevojë, na mburr trimërinë:
«O burra! — na thotë, — trima Shqipëtarë!
Në luftë të vini, të vriti më parë!»

3. LOPA, DHIA, DELIA DHE ASLLANI.

Mos bëjë kurrë njeri
me të mëdhenj shoqëri.
Lopa delia dhe dhia
u bënë shoq me asllanë,
u ndanë nga bakëtia
dhe për gja një ditë vanë.
Kur hynë ndë një përrua,
asllani thotë: «Qëndroni! —
Dhe ndënji pak u mendua: —
O shokë, thiri, dëgjoni:

ç'më duhet gjau mua?
Lopa, delia dhe dhia
janë mjaft, të tjera s'dua!»
Dhe i çau që të tria.

4. QËNI DHE HIJEJA.

Një qen me ca mish në gojë
nëpër lumë do të shkojë.
Është ujët si pasqyra:
qënitë ju duk fytyra,
ju duk dhe mishtë më shumë!
hyri ta zërë në lumë.
Fatziu mbeti pa mish,
se humbi dh'atë, që kish,
se e la e mori vala.
Dëgjoni ç'thotë përralla:
njeriu që vë tama
humbet dhe gjënë që ka.

5. NJERIU I SHTRËNGUAR.

Kush është i shtrënguar,
dridhet për paranë:
gjithë ç'ka fituar
s'i ha po e hanë.

Nukë menton lumi,
se ka për të vdekur
dhe kur e zë gjumi
bie fle si ljepur.

Ruan gjën' e tia
t'ja hanë të tjerë
dhe vdes nga uria
mos me keq i mjerë.

6. KORRIKU.

Na erdhi Korriku prapë
me grurë të ri, me vapë.
Mirë q'erdhe, o Korrik,
Gjithë bota të ka mik.
Të duanë varfëria,
se s'vdes njeri nga uria.
Korriku, si flak' e drizit,
na ngroh placën e kurrizit.
O Korrik, o faqezjarr,
gjithë lule, gjithë bar,
dhe me pemë barrë-barrë,
s'dimë ç'të hamë më parë.
Në Korrik piqen me radhë
pjeshkë, mollë, thanë, dardhë;
kur afërohet Korriku,
zë të piqet dhe fiku.
Nga gjithë pemët e tjera,
fiku na mbiftë te dera,

se gjer sa ka shporta fiq,
gjithë bota janë miq...
Me shpresë të këti muaj,
punëtor puno e vuaj.
Të punojmë që të gjithë,
të mos mbetemi pa drithë,
se në këtë muaj Zoti
na kërren nga tërë moti.
Ata që kanë punuar,
në Korrik janë gëzuar,
se në këtë deli muaj
nukë ka lëmë pa duaj.
Vjen Korriku! Punëtorë
mirri drapërin në dorë,
të korij kush ka punuar,
kush ka mbjell' e ka lëruar.
Dilni, dilni nëpër ara
e shini ç'ka bërë fara;
shikoni një koqe gruri
se sa koqe grurë pruri.
Shikoni kallijtë e verdhë
në Korrik duanë mbledhë.
Shihni, shihni kur fryn era,
kallijtë lozin si shqerra;
me diell, kur fryn veriu,
si floriri ndrit kalliu.
Fusha, ara, palë-palë
duken si deti me valë.

Fush' e gjatë, fush' e gjërë,
pse më bën të qaj ngaherë?
Me djersën e varfërisë

gjith' arat e Shqipërisë
vaditen e gjë s'kërrejnë!
se të huajt' i rrëmbejnë!
Shqipëtari, dëm e kotë,
punon gjithënjë për botë:
aratë që mbjell, ngaherë
ven' e i korrin të tjerë!
O Korrik, o faqezjarr,
je dukur dhe luftëtar:
ndë Francë (kush nuk e di? ¹⁾)
u ngre vendi për liri;
në Korrik lufta u zu
u bë gjaku gjer në gju...
Kryeqitjetë q'u bënë,
prej Korriku janë zënë;
se zjarrë që ndes Korriku,
nuk e shuan dot armiku;
se dielli është' i ngrohtë,
ndes gjaknë ndë gjithë botë.
Gjaku i trimit vërtetë
për Liri ndizetë vetë;
gjaku yt, o Shqipëtar,
s'të ndizet as në behar!
Të ndestë vap' e Korrikut
t'i biesh në kok'armikut!

1) Bëhet fjalë për revolucionin francez.



NGA PERRALLAT E LA FONTENIT

JEAN DE LA FONTAINE

Ish një vjershëtor frances, lindur në vitin 1621, vdekur në Paris më 1695. Ka qënë gjator i prapë dhe pëlqente jetën fusharake. Donte shumë shtasët dhe shpesët. Në përrallat që ka shkruar kaqë bukur, i bën të flasën e të kuvendojnë me vjersha të hijëshme. Ca nga këto përralla i këtheva në gjuhë tonë, se m'u duk pun' e dobishme për letëratyrën shqipe, sot fort e dobët. Përdora vjersha të këmbyera me vargje të trazuar se desha të shkel në gjurmë të vjershëtorit që përmenda. Këndonjësi do të shikojë vetë në ka ndonjë rëndësi a dobi kjo vepër, po sidomos i lutem të mos harrojë kurrë që çdo shqipëtar duhet të punojë për shqipen sa të mundet. . . 1)

A. ZAKO

1) Këto përralla janë nxjerrë nga vëllimi i Çajupit «Përralla të zgjedhura nga të vjershëtarit math La Fontaine», botuar më 1921. Kjo është e vetmja vepër e tij, botuar posaçërisht për fëmijët, siç shprehet dhe ai «për çunat shqipëtarë». Në faqen e parë të këtij vëllimi ndodhet shënimi i mësipërm për Zhan de Lafontenin, fabullistin e mirënjohur francez.

PËR ÇUNAT SHQIPËTARË.¹⁾

Kujt t'ia fal këto përralla
fort të rralla?
«La Fontaine» kur i shpalli
të birit mbretit ia fali.
Shqipëria s'ka mbret sot,
po mund të ketë gjer mot,
me fuqi të perëndisë.
Gjer sa të vijë kjo orë
do t'i fal dorë-më-dorë
te çunat e Shqipërisë,
se janë shpresë e lirisë.
U lutem të mos përtojnë,
po të rrinë t'i këndojnë,
kur të vdes të më kujtojnë.

1) Vjersha e Çajupit «Për çunat shqipëtarë», me të cilin hapet vëllimi i përrallave të Lafontenit, zë vëndin e kushtimit autorit. Çajupi kishte besim të madh tek brezi i ri, prandaj dhe e quante atë «shpresë e lirisë».

CINXURI 1) DHE MILINGONA 2).

Cinxur' i marrë,
gjithë beharë
e shkoi duke kënduar
ndë kopshtira të lulëzuar.
Po behari shkoi
cinxuri pushoi
dhe zuri të qajë
se s'kish se ç'të hajë.
Të mos vdesë nga uria
një ditë del nga shtëpia
dhe milingonës i thotë :
«Zonjë, sot bën shumë ftohtë,
s'kam ç'të ha dhe jam sëmurë,
po nëmë dy koqe grurë,
ta kthej prapë në korrik
Në më ke gjiton dhe mik
të të vijë keq për mua»,
Po milingona s'ep hua,
se është fort e shtrënguar
«Në behar ç'paske punuar?».
thotë zonja milingonë.
«Këndova për Zonë,
beharë të tërë
ndë fush' e ndë male».
« — Fort mirë ke bërë
tani hidhu valle!»

1) cinxuri = gjinkalla.

2) milingona = miz' e dheut.

KORBI DHE DHELPA.

Tek një lis, sipër në majë,
korbi qëndroi të hajë
një copë djathë që mbante
ndë qeft ¹⁾). Kur nisi ta hante,
shkon një dhelpër' e mallkuar
se i ra erë djathi vjeshtuar,
dëshiron ta hajë vetë
dhe i tha korbit me bisht përpjetë :
«Mirëdita, mik i vjetër !
Bukurinë tënde nuk e ka zok tjetër,
me pendë të bardhta. Në di të këndosh,
përmi zoq të tërë do të mbretërosh»
Të tregojë zënë. zoti korb gërthiti
dhe lëshoi djathët, po dhelpra ja priti
dhe korbit i tha :
«Ndëgjo budalla !
Ata që lëvdojnë,
me gjë të botës duan të rrojnë.
Zot kjo këshillë që të rrëfeva
sot, vlen më tepër
se cop' e djathit që të rrëmbeva». —
tha zonja dhelpër
dhe iku me bisht përpjetë.
Korb' i shkretë,
korb' i mjerë
u turpërua
dhe u betua
të mos gënjehet dhe tjetër herë.

1) qeft = sqep.

BRETËKOSA QË DO TË TRASHET SA NJË KA

Bretëkosa sa një ve
pa një ka sa një deve
dhe nakari nuk e la,
desh të trashet sa një ka.
Kur vu këtë gjë ndër mend,
vate u shtri ndë një vend
duke ngrën' e duke pirë
që të fryhet ca më mirë.
«Shihni, shihni sa u rrita !»
thërrit' e thoshte përdita:
«Mos u mburr e mos u mbaj»,
i thoshnë shoqet e saj.
«Shini, nukë jam sa demi?
— Jo! — Shikoni.— Jo, të themi.
— Pa shikoni këtë bark
si të kaut.— Jo, je lark»
Bretëkosa, nga marasi.
u fry, u fry gjersa plasi.

Shumë njerës në këtë botë
thonë se janë të zotë
si ata që kanë dhe ata që s'kanë
pandejnë çoç ¹⁾ janë,
si bretkosa mendonën,
mburen e levdonen.

1) çoç = se çfarë.

Dy mushka një ditë muar
 udhë bashkë ndë rrëpira :
 njerën e kishnë ngarkuar
 me dy thasë plotë me lira ; ¹⁾
 tjetëra me samar,
 ngarkuar me bar,
 dukej si kopile
 e para me zile,
 kapistra me lule,
 na mbahej fodulle,
 Duall dy hajdutë
 me pall' e me hutë
 dhe mushken e ngratë
 që mbante paratë
 njeri e çkarkonte
 dhe tjetëri e çponte,
 se nukë qendronte.
 E lanë të çalë ;
 s'qëndronte dot mbë këmbë
 s'i mbenë dhëmballë
 ndë nofull, as dhëmbë,
 nukë mban dot lotë
 Mushka tjatr' i thotë :
 «Motrë, te kjo botë
 kush do madhërinë
 kush mburet si tinë
 si ti kush punon,
 të tilla pëson.
 Tek ti është faji :

1) lira = para të florinita.

të bëje çdo punë,
të jeshë si unë
mushkë millonai
ngarkuar me bar,
jo me thes me ar,
tani do të keshe
dhëmbë dhe dhëmballë,
nukë do të jeshë
sot ndë këtë shkallë,
e sëmurë, e çalë».

UJKU DHE QËNI

Një ujk plak, i thatë
Si dru nga urija
pa një qen, një natë
jashtë nga shtëpia,
që rrinte ndë portë.
Duante ta hante,
po s'mundte ta mbante :
qeni ish m'i fortë.
Ujku, me fjalë të mira,
me lajka, me dhëlpërira,
përpara qenit qëndronte,
i flet, e mbur, e lëvdon :
«Mik gëzohem që të pashë,
fort të bukur e të trashë
fatmirosh me të vërtetë ;
Zot' i math të faltë jetë.
— Mik, në do të jesh si unë —

thotë qeni ; bën një punë :
ikë nga malet me gurë
se nukë gjen bukë kurrë
mos rro mik si egërsirë.
Në do të shkosh mirë,
eja sot me mua,
në do të mos vuash».

Ujku u gëzua
«Te paça, më ruash ;
se mik si ty s'gjej.
Që të roj si tinë,
ç'punë do të bëj?

— Vetëm të ruash shtëpinë
nga njerst'e liq, nga hajdutë,
të duash të tutë ;
ndë shtëpi të riësh,
të hash e të pish.»

Ujku plak nga këto fjalë
u gëzua fort në ballë ¹⁾
dhe me këtë gas

mori qenë pas,
Duke ikur brek më brek
dhe ndëpër rrëpira :

«Pse nukë ke lesh ndë zverk?»
i tha qenit egërsira.

«S'kam gjë. — Me mua mos qesh,
folë.— Besa ! — Të kam bir,
ndë zverk pse nukë ke lesh?»

— Pse ri lidhur me zinxhir.

— Lidhur me zinxhir? Ç'më thua?

Kjo jetë s'është për mua !

1) në ballë — në fillim.

Të mos vete tek të dua!
Mos e dhëntë Perëndia!
— Pse? — Pse, thotë! Me pahir:
që sot të ngorth nga uria,
se të lidhem me zinxhir!
Jo, tha ujku, për të ngrënë
nuk e humb lirinë vet!»
dhe me vrap u nda me qenë
dhe mori malë përpjetë
nga frika se mos e zënë.

LOPA, DHIA, DELJA DHE LUANI.

Ndë kohë të vjetër,
një lop' e një dhi
dhe një dele tjetër
bënë shoqëri
bashkë me luanë.
dhe për gja tok vanë,
Një ditë të shtunë,
një zorkadhe zunë
brenda në një ferë
Luani, sakaqëherë
e mori, e çau
me thonj vet e ndau
bëri katër copa
ashtu si desh lopa.
«Cop' e madhe, — tha, — për mua, —
se jam luan dhe kshtu dua:
cop' e dytë, besa — besë

më bie vetë ndë pjesë ;
dojni s'dojni do ta marr,
se sot s'jemi mbarabar ; 1)
dhe këtë copën e tretë
jam i zoti e marr vetë
si kam gjithnjë zakonë ;
Cop e katërt për Zonë,
imja qoft pa dyshim,
se jam trim».

DRAGONI ME SHUMË KOKË DHE DRAGONI ME BISHTRE SHUMË.

Një Turk gjeti një Gjerman
dhe i tha : «Ndë këtë botë
nukë ka tjetër sulltan
më të math e fuqplotë»
Hidhet e thotë Gjermani
— Ç'thua? Ç'janë këto fjalë?
Si mbreti i ynë tjetër s'ka dalë.
Është m'i fort, zot, nga sulltani ;
Imperatori ka sot ndë dorë
plot elektorë
që sulltani nuk i ka,
dhe gjithkush nga këta,
kërren ushtarë,
trima të mbarë
kaqë shumë,
more lumë,

1) mbarabar = të barabart, njësoj.

sa mund të prishij a të përzërë
nj'ushtëri të fortë të tërë
— Vërtet, vërtet, kam dëgjuar, —
thotë turku fort i zgjuar,
për elektorët, janë të zotë
dhe fuqplotë.
Po dëgjo se ç'më ka ngjarë
ca ditë më parë.
Ndë një garth pashë
një dragua fort të trashë,
kish njëqind kokë
Jeshë pa shokë,
nga frika gjaku më ngriu
(Ndë rrezik trembet njeriu)
Për fat të mirë
kjo egërsirë
s'gjeti dot vënd që të shkonte
të më copëtonte.
Ky rrezik i vjetër
s'kish shkuar mirë për mua,
kur pash ndë një garth tjetër
një tjetër dragua. —
Ky vërtet një kokë kish,
po me njëqind bishtre ish,
dhe fort i trashë.
M'u droth gjaku kur e pashë,
Bishtret me radhë
çpejt hapnë gardhë
koka dolli nga një vërë,
pastaj dolli kurm' i tërë
Besomë, zot, mbretërit tanë
që të dy të tillë janë».

HAJDUTËT DHE NJË GOMAR.

Dy hajdutë ndë pazar
qërtojnë për një gomar,
njeri do ta shesë, tjetëri do ta ketë.
Tek po rahen duke sharë,
qaset një hajdut i tretë
dhe vete u merr gomarë.
Gomar, më tjetërë kuvend
është një komb a një vend
dhe hajdutët që qërtojnë
janë mbretërit që kërkojnë
t'i zotrojnë.
Zën' e lëftojnë
me njeri-tjetërë
si njers' të marrë
kur vjen një tjetërë
më trim, m'i fortë,
dhe merr gomarë.—
Kush e mbolli, mos e korrtë.

VDEKJA DHE NJERIU I MJERË.

Një njeri njëherë
i varfër, i mjerë
s'donte të rronte,
kërkonte vdekjen që të shpëtonte;
s'lodhej të thotë
«S'jam i gëzuar ndë këtë botë

Vdekje, o vdekje, sot të kërkoj!
Të lutem mermë që të shpëtoj!
Të vdes më mirë!
Me vrap dhe me dëshirë,
vdekja hyri ndë shtëpi.
Kur e pa miku thirri: «Ç'je ti?
Ç'më do? Ç'kërkon këtu sot?
Largoju se s'të shoh dot».
Meqenas ¹⁾ njeri me mend,
ka thënë këtë kuvend:
«Le të jem i çalë
dorac, kuris-dalë,
po të jem i gjallë,
të rroj shumë vjet këtunë».
Vdekje, dhe unë kshtu dua,
nukë ke punë me mua,
me vrap largoju nga unë.

VEKJA DHE NJERIU NGARKUAR ME DRU

Një plak fatzi
me dru ngarkuar,
vjen ndë shtëpi
duke rënkuar.
Këmbët s'i punojnë
se drutë rëndojnë.
I mjeri plak
të çlodhet pak

1) Meqenas = Mesena një pasanik romak që përkrahte e ndih-
onte zhvillimin e arteve.

drut'i çkarkon.
Që kur ka lerë
shumë ka vuar;
s'ka njerës të tjerë
më të munduar,
zbathur e pa brekë,
pa dark' e pa drekë
gruaja, fëmija
q'i merr sot uria, —
të tëra këto të gjara
ndër mend i shkon;
vdekjen kërkon,
Vdekja s'mënon.
i del përpara
«Ç'më do? — i tha
me zë të butë —
«Të më ndiç¹⁾ të ngarkoj drutë».
I tha plaku kur e pa.

DHELPA DHE LELEKU.

Dhelpra thiri ndë shtëpi
një lelek, se kish gosti.
U shtruan ndë një mësallë
dhe zunë bashkë të hanë
vetëm një sahan me dhallë
tjetër gjellë nukë kanë.
Leleku me qeft²⁾ të gjatë

1) të më ndiç = të më ndihmosh.

2) qeft = sqep.

s'hëngri fare atë natë,
se zonja dhelprë s'e prifi,
dhallët me vrap e glabiti.
Po leleku këtë dhunë
q'i bëri dhelpra, nuk e haronte.
I tha një ditë: «Të viç tek unë,
të hamë sonte.»
«Zot, do të vi, —
tha zonja dhelprë, —
Me miqt' e mi
s'bëj naze tepër».
Dhe vate,
Ndaj nate.
Leleku mish bleu
e vuri e zjeu;
copa-copa kur e preu
e vuri ndë një shishe
që kishte lënë përdhé
Erdhi ora që të rinë
bashkë të han' e të pinë,
dhelpra u gëzua
se ra er' mishi,
lëvdoi miknë q'e grishi,
pastaj këmbëkryq u shtrua,
me gas të math atë natë.
I suall kastile
mishtë ndë botile,
me fyt të ngushtë e të gjatë,
ku qeft i zogut shkon më tepër,
po jo dhe goja që ka një dhelprë.
Për këtë shkak,
dhelpra s'hëngri dot aspak,

s'vuri dot mish ndë dhëmballë
dhe iku me bisht ndë shalë.
Ju që punoni
tekdo me dhunë,
të tillë punë
do të pësoni.

DJALI DHE DASKALI 1)

Në këtë përrallë
shomë një njeri pa mend.
Afër lumit, ndë një vend,
luante një djalë
faqekuq si shegë,
desh u mbyt se ra ndë lumë,
po u ndodh një shelk që kish dega shumë:
fatmirosh, çuni zuri një degë
dhe u var që të mos bierë.
«Ndhmë!» thërriti çun' i mjerë,
që të shpëtonte,
se pa një daskal që shkonte.
Mësonjës' i mallkuar,
varur kur e pa,
bëri kryq me të dy duar
dhe tundi kokën e tha:
«Mos më keq!
Shini, shini këtë dreq!
Djemtë sot janë shejtanë,
mjerë ata q'i kanë,

1) Daskal = mësues.

se janë për derra!»
Kur foli këto daskali
dhe shumë fjalë të tjera,
u qas te diali
prap e qërtoi,
nga rreziku e shpëtoi.
Shumë njerëz janë
si ky daskali,
plot fjalë kanë,
i marrtë djalli.
Ndë rrezik kur na shikojnë
qesëndisin e qërtojnë,
na këshillojnë,
po s'na ndihmojnë
Të lutem, mik
ashtu më rruash,
të më shpëtosh ndë rrezik,
pastaj folë sa të duash.

KOKOSHI (GJELI) DHE MARGARITARI

Një gjel, kokosh a këndes,
kur u zgjua në mëngjes,
gjeti një margaritar,
jashtë ndë një shesh me bar.
U ngrë, vate me nxitim
e shpu tek një kujunxhi
dhe tha: «Kur se ha dot kurrë
këtë gurë, çdo ta bëj unë?
Për mua, një koqe grurë

më hyn më mirë ndë punë».
Një njeri
pa dituri
kish gjetur një dorëshkrim
me vjersha që s'kishnë çmim,
dhe u ngrë vate ta shesë
se ta këndojë s'ka shpresë
e këqyri me dëshirë:
«Vepra më duket e mirë,
tha, po vete bosh,
ç'do ta bëj këtunë? ·
Për mua, një grosh
më hyn ndë punë».

GRERI DHE BLETËT.

Bletët, Zoti na i faltë,
u zunë me arrëza ¹⁾
për një koshere me mjaltë
si thotë përrallëza;
me njera tjetër u rranë
dhe në gjyq u ngrën' e vanë
tek një grerë, t'i gjykojë.
Greri ²⁾ që të kuvëtojë
të vërtetën, tjetër ditë
dërgoi pruri shahitë
dhe këta i thanë:
«O Zot, kemi parë

1) arrëza = insekt që i ngjan bletës, por që nuk bën mjaltë.
2) grera = insekt më i madh se bleta, që të pickon.

ndë koshere pranë,
ca muaj më parë
miza me kra
dhe të mëdha
që fluturojnë
dhe, kur qërtojnë,
dinë të çpojnë,
si bën një bletë».
Me të vërtetë
zoti kati
si të gjykojë sot s'di
Vetë mendonte e thonte:
«Si këto miza ndë botë
janë bletët, si më thanë;
po dhe arrëzat kshtu janë,
si dëgjoj e shoh në jetë.»
«Kati, të lutem mos druaj,
me gënjeshtër nuk u ngose?
Sot u bënë gjashtë muaj
dhe gjyqnë, zot, nuk e sose!
Puna jonë s'vete mbarë
është më keq se mëparë:
mjalta do të priset
se kosherja grisët.
Prandaj, zot, për kokë tuaj,
të lutem prap mos druaj,
Zot'i math të faltë.
Vërna të punojmë
të dy palët, të shikojmë
kush di e bën mjaltë,
arrëza a bleta».
Dolli ndë shesh e vërteta:

këtë fjalë kur dëgjuan,
zonjat arrëza pushuan,
se hanë mjaltë kur gjejnë
po nukë dinë ta bëjnë.
Greri kati kupëtoi
t'ipete prapë ndë bletë
kosherja me gjithë mjaltë.
Zot' i math e fort i naltë
na faltë ndë këtë jetë
ca gjykatës të këtillë
për çdo punë e çdo këshillë
që të gjendën ndë çdo vënd.
Sot, këta që janë
na vjedhin, na hanë,
na rjepin, na zveshin
dhe me neve qeshin
për një koqe vé
na shesin shtëpinë,
dhe në fund pendët mbetën për ne,
pula mbetet për katinë.

NJË MBLEDHIJ ¹⁾ QË BËJNË MINJTË.

Thonë, një maçok i shkretë
kish dërguar nd'atë jetë
shumë minj që kishte ngrënë
ca të pakë që kish lënë
futeshin vërë më vërë.
Maçi një dit' u largua

1) mbledhij = mbledhje.

të gjejë një maçe që ta marrë grua.
Atë ditë, minjtë mblidhen tok të tërë,
djem e pleq,
mendonen e bisedojnë
me ç'menyrë të shpëtojnë
nga ky drej.

Një mi me mend,
në këtë vend

hidhet e thotë:

«Shokë, ne jemi të zotë
t'i varim maçit një rrile,
sot ndë qafë si një zile.

Kur të vij të na zërë
do të mundim ta dëgjojmë,
do t'ikim me vrap të tërë,
nga vdekja do të shpëtojmë».

Gjithë minjtë këtë fjalë
e pëlqyen fort ndë ballë
po kush i qaset maçokut?

Thonë shoku shokut:

«Kush mund të vejë kastile
t'i vari maçit një rrile ¹⁾?»

Kush guxon t'i vejë pranë!
Gjithkush thosh: «S'jam i marrë!»

Këtë punë kur e panë
plot me rrezik, mijt u ndanë
ndëpër vrima prapë vanë,
dhe u fshenë si më parë.

Shokë, si u suall miu
sillet e flet dhe njeriu.

Shumë mbledhje kemi parë

1) rrile = zile e vogël.

q'u nish' e s'u sosnë mbarë.
Kur është vetëm një fjalë
plot njerës me mend kanë dalë,
po kur vjen radha për punë
s'gjen asnjë njeri këtunë.

UJKU QË GJYKOHET ME DHELPËRËN PËRPARA MAJMUNIT.

Tregojnë se një ujk plak
zu një dhelpër vjedharak
dhe nukë priti
ndë gjyq e ngriti.
Një majmun ishte kati ¹⁾.
Avokat s'vunë njeri
të dy palet vetë vanë,
kuvenduan,
kundërshtuan,
të dy shumë fjalë thanë.
Majmuni kur i dëgjoi,
kupëtoi
atë ditë
djallëzitë,
«U di' mir' u di, —
tha zoti kati. —
E mora vesh ç'ini,
Oë të dy faj kini,
aë të dy do t'u gjykoj
dhe do t'u dënoj.

1) Kati = kadi = gjykatës.

Ti ujk qahe sot pa vrrarë,
se gjësend s'të kanë marrë,
Ti dhëlpër me këtë kokë
je vjedharak që s'ke shokë».
Kurdoherë
që kini për të gjykuar
njers të liq, s'duhet menduar
gjat' e gjerë.

DY DEMA DHE BRETAKOSA.

Dy dema trima njëherë
lëftonin për një mështjerë¹⁾
cilido vetë
kërkon ta këtë.
Një bretkosë i shikon,
psherëtit edhe rënkon.
Një shok i tha:
«Ti ç'ke që qa?»
Tha bretëkosa: «Dreqi të marrtë,
s'e mendon fundë ndë këtë qartë
ku do të dalë?»
Me tjtatër fjalë
demat lëftojnë sot për një lopë
dhe kush të mundet do të kërkojë
të futet ndë këtë gropë
që të shpëtojë.
Do të na shkelij, do të na vdesë,
s'na mbeti shpresë».

1) mështjerë = viç i rritur.

Bretkosa që kish frikë
ish me mend:
një dem u fut pas një çikë
n'atë vend,
dhe më së fundi
shkeli sa mundi
nga bretëkosat,
nga kagëzozat ¹⁾
Nuk u gënjej
njerst' e mëdhej
bëjnë trazira
dhe marrëzira,
kurdoherë
të vegjit paguajnë
heqin dhe vuajnë
për të tjerë.

NJË LAKURAOËS DHE DY NUSE TË LALËS

Një nus' e lalës njëherë
kthehet ndë fole, ndë derë,
sheh një lakuraq të zi,
fshehur prapa shkallës, —
e mori për mi.
«Qysh guxon të viç këtu? —
thotë nus' e lalës, —
Nuk e di se kush jam unë?
Minjtë të tërë
i kam armiq»
Thotë lakuraq' i ngratë:

1) Kagëzozat = bretkocat.

«Unë mi s'jam, paç uratë,
se jam zok, shikomë kratë.
Rrofshin zoqtë punë mbarë
dhe minjtë dreqi t'i marrë!»
Nus' e lalës i besoi
këto fjalë
dhe lakuraqi shpëtoi,
mbeti i gjallë.
Kur shkuan dy ditë të tjera;
lakuriqn' e hodhi era
ndë një fole më të gjërë
ku gjeti, ndë fund të shkallës
një tjatër nuse të lalës,
që nukë do zoqt e mjerë.
Lakuriqi këtë herë
gjendet ndë rrezik i gjori,
i zot' i folesë
për një zok e mori
dhe kërkon ta vdesë.
Lakuriqi thotë,
duke fshirë lotë:
«Zonj' e madhe, ndjemë!
Lemë të rroj, lemë
se zok nukë jam,
mos të vij rëndë;
zoqtë kanë pendë
unë nuk kam.
Jam mi, — minjtë rrofshin!
Maçokët u shofshin
me far' e me fis!»
Nus e lalës u kandis
lakuriqi u ngré e shkoi,

nga vdekja prapë shpëtoi.
Rreziknë për të mërguar
nga vdekja për të shpëtuar
njeriu ndë këtë botë,
si duan të tjerët thotë,
ndërron mend
ndë çdo vend
dhe bën
si gjen.

ZOGU I LAVOSUR ¹⁾ ME NJË PENDË.

Një gjator mori një pendë
një ditë, dolli goditi
një zok. Kur u lavos rëndë
zogu pshoi, thirri briti.
«Me pendët që na ke dhënë,
Zot, rëmojmë varrë tënë,
dhe me duart e njeriut
i bëjmë të keq vetiut!
Njers, o njers' sa të liq jini!
Me mjeshtëritë që dini,
me pendët tona kur kini,
bëni armë të na vrini.
Po dhe ju, more të mjerë
me fuqi të Perëndisë,
jini si ne shumë herë:
vërtet, gjysm' e njerëzisë
godit armë për të tjerë».

1) lavosur = plagosur.

BUSHTRA ZAGARE DHE SHOQE E SAJ

Një zagare¹⁾ me bark plot
qante një ditë me lot,
se s'gjente vend për të pjellë.
Një bushtrë tjetër, një mike,
që kish një kotec të thellë,
q'ish zemër mirë e besnike
kur pa shoqenë tek qaj,
e shpu ndë kotec të saj.
Pas pak dit', zagarja polli,
bushtra nga folea dolli.
Ndë këtë pun' u gënjye.
Pas njëzet dit', kur u kthye,
zagarja i flet nga dera:
kërkon njëzet ditë të tjera,
këlyshët janë të vegji
dhe s'mundin t'i venë pas.
Me këto fjalë që gjegji
bushtra iku dhe s'u qas.
Pas një muaj ndëpër vapë
u kthye ndë kotec prapë,
t'i thotë mikes pa vonë
që t'i lëshojë shtëpinë,
se tani s'është lehonë
dhe këlyshët pas i vinë.
Po zagarja del ndë derë,
tregon dhëmbët këtë herë,
thotë: «Dal, me djem që kam,
në guxon të viç tek jam,
të na nxjerç jasht ndë portë».

1) zagare = qeni femër.

Këlyshët ishin të fortë.
Njerst' e liq të tillë janë,
mjer ata q'u ndinë;
me zakonet që kanë
të mirën s'e dinë
se jan' egërcirë
dhe s'punojnë dreq;
kush u bën të mirë
do të gjejë keq.

SHQIPONJA DHE BRUMBULLI

Shqiponja një ditë del,
ndë një vënd sheh një kunel ¹⁾
dhe sulet ta zërë.
Ky, me mëndje trumbull,
do të futet ndë një vërë
tek rrinte një brumbull.
Këtu shpëtim s'mund të gjëjë,
po nga frika s'di ç'të bëjë.
Kur u qas zonja shqiponjë,
del brumbulli zemërmirë
dhe i thotë me dëshirë:
«Mbretësh' e zonjë,
Zoti të faltë një djalë,
të lutem, për Zonë,
le këtë kunel të gjallë,
se jemi gjitonë».
Këtë lutje s'e ndëgjoi

1) kuneli = lepuri i vogël.

shqiponja dhe hapi krahtë,
rrëmbeu kunel' e ngratë
dhe me rrëmbim fluturoi.
Brumbulli u zemërua
dhe me vrap u afërua,
u ngjit ndë një shkëmb përperjetë,
te kishte shkaba fole,
dhe theu të tëra vetë,
se shqiponja s'kish atje.
Kur vate s'gjeti një ve,
thirri, briti,
ulëriti
për këtë shkak,
nukë di kush ja ka bërë
këtë gjëmë, që ta zërë,
të marrë gjak.

Nukë kish m'e madhe gjëmë:
atë vit s'u bë dot mëmë.

Vitnë tjetër, zok me mënd,
bën fole ndë tjetër vënd;
po brumbulli prap e pa
dhe ve ndë fole s'i la.

Shkaba mbeti pa fëmijë,
nuk e nxë vëndi të rrijë,
ulërin e qan me lot,
nukë ha, nukë fle dot.

Vitnë tjetër, vet' i mori
shkaba dhe vate me nder
majë malit, te Tomori,
gjer te Zoti Jupiter.

Mori vetë me dëshirë
dhe ndë prerë ja lëshoi;

që t'ja ruaj' ca mirë,
Ganimidin ¹⁾ kujtoi,
që kish rrëmbyer ndë Trojë ²⁾
dhe ja kish shpurë përpjetë
Këtu kush do të guxojë
të vejë t'i thyej vetë?
Po dhe brumbulli s'mënon,
një koqe bajgë lëshon
te Zoti. Pa marrë vesh,
ky tundet
dhe shkundet
dhe vetë ranë në shesh.
Për këtë gjëmë,
shqiponja mëmë
u hidhërua,
u zëmërua
me Jupiterë,
dhe u betua
se tjatër herë
s'do ta shërbojë,
sa të jet' e sa të rrojë.
Po zoti Jupiter s'foli,
brumbullin solli
që ta gjykojë.
Kur e dëgjuan
brumbullin plak,
gjukatarët kupëtuan
se shkaba nuk kish hak.
Zoti brumbull u gëzua,
shqiponja u zëmërua

1) Ganimidi, princ Trojan, të cilin Jupiteri, duke u bërë shqiponjë, e rrëmbeu dhe e bëri verështënës të perëndive.

2) Troja = qytet i vjetër në Azinë e vogël.

tepër me një gjyq të tillë,
thirri, briti si e pirë.
Oë ta marrë me të mirë,
Zoti dha këtë këshillë:
të mos pjellë tjatër herë
as ndë behar, as ndë verë;
ndë dimër të bëjë ve
ndë fole,
se kur zë bën ftotë shumë,
brumbulli bie ndë gjumë
ndënë dhe.

LUANI DHE KUNUPI¹⁾

«Çporru, çporru, s'të shoh dot!
Si ti ndë dhe — krimba plot!»
Luani, me këto fjalë,
një kunup shan e qërton,
po kunupi s'e peshon,
i qëndron ballë për ballë.
«Me këto fjalë që flet,
ç'pandeh, i tha, se je mbret?
Frikë s'kam as do të kem,
dhe për mbret nukë të dua;
s'je m'i fortë se një dem
dhe nuk e nxjerr dot me mua».
Kunupi, me këto fjalë,
niset për luftë ndë ballë
dhe vete, vjen ndë çdo anë,
thërret, bërtet, çpon luanë.
Kur hidhet e çpon ndë gisht,

1) kunupi = mushkonja.

kur ndë bark e ndënë bisht,
kur ndë vesh e kur ndë hundë.
Mali dhe fusha u tundë,
se luani, nga inati,
briti me fuqi që pati,
se s'mundi të zër' armiknë.
Ndëpër shpella, tek u ndodhë,
shtasat e tjera u drodhë,
nga frika u ngren' e iknë
ndëpër shkretëtirë.
Dhe këtë trazirë
ndë botë të tërë
një miz' e kish bërë!
Dhe luan' i mjerë
nukë mund ta gjëjë,
godit bishtin nd'erë,
nukë di ç'të bëjë;
sulet e vërsulet
dhe bije ndë shesh,
se kunup' i ngulet
ndë hund' e ndë vesh.
Kur e sheh përdhe luanë,
kunupi gëzonet,
mburret e lëvdonet,
më të katër anë,
se do bota ta nderojë,
për trim të math ta tregojë,
Nukë kërkon tjetër pagë
kunup' i marrë,
po ra tek një merimangë,
q'i bëri varrë.¹⁾

1) Është shkurtuar.

NJË GOMAR NGARKUAR ME SFUNGAR 1)
DHE NJË GOMAR NGARKUAR ME KRIPË

Një njeri kish dy gomarë:

një dit' u vuri samarë,

se nisej për ndë pazar.

Ngarkon njerin me sfungar,

pastaj ja hipën dhe vetë,

se sfungari është i lehtë.

Tjetri, me kripë ngarkuar,

mbarit, po duke rënkuar,

ngulçon e çalon,

se kripa rëndon.

Udhëtarët, brek më brek,

Duke shkuar ndëpër ara

për të vatur ngjer ndë treg,

gjejnë një lumë përpara

me ujë shumë.

Gomari me kripë, do s'do, hyn ndë lumë

Desh u mbyt i gjori,

lumi desh e mori,

nga frika pëllet,

s'di se nga të vejë;

po doli përtejë,

se kripa u tret.

Sa për gomarë

që kish sfungarë,

kur pa shoknë më të lehtë,

ndë lumë hyri dhe vetë

tok me njerinë,

po, mjerisht ndë mes qëndruan.

1) sfungar = sfungjer = shpuzë.

se sfungarët u rënduan

ujë kur pinë.

Kush nukë piu?

Piu njeriu,

piu gomari,

piu sfungari.

Të mos i kishnë shpëtuar,

do t'ishnë mbytur të tërë.

Zoti, që na ka gatuar,

këtu nukë na ka bërë

që të mbarojmë çdo punë.

Atë që bëj unë,

ti s'e bën dot

as sot, as mot.

LUANI DHE MIU

Ndë këtë botë, sa rrojmë,
njeri-tjetrin të ndihmojmë:
i math, i vogël, të tërë ç'jemi,
për njeri tjetrin nevojë kemi
ndë këtë jetë.

Për këtë gjë të vërtetë,
dy përalla do të themi,
Një mi, kur dolli nga dheu,
ndë thonjt të luanit ra;
po luani, kur e pa,
zëmër të madhe rrëfeu,
se minë të gjall' e la.

Po dhe miu, kur shpëtoi,
të mirën nuk e harroi,
me të tepër ja pagoi.
Një luan, një egërcirë,
pa të mirë nga një mi,
si s'e pandente njeri.
Ndë një pyll, ndë shkretëtirë,
i mjeri luan
u zu ndë dhokan: 1)
thërret, bërtet, qan me lot,
se nga dhokani s'del dot,
q'e zuri ndë këmbë.
Po miu, me dhëmbë,
ep e merr
sa e nxjerr;
hyn e del,
prish një tel,
të tërë dhokanë,
dhe shpëton luanë.

Fucia dhe zëmërimi
s'mbarojnë ç'mbaron durimi.

1) dhokan = kurth, lak.

PLLUMBI DHE MILINGONA

Një milingonë njëherë
ra ndë një pellg mjaft të gjerë
dhe, duk me mos ditur not, ¹⁾
do të mbytej, se s'dil dot.
Një pllumb q'u ndoth nd'ato anë,
merr një kasht' e ja heth pranë.
Kur u ngjit ndë këtë kashtë,
milingona dolli jashtë.
Tatëpjetë, nga një breg,
vjen një gjator me dyfeg
dhe bënet gati të shtjerë
dhe të vrasë pllumbn' e mjerë.
Pandeh q'e ka ndë tenxhere ²⁾
po milingona ahë,
kur e pa gjatorë
me pushkë ndë dorë,
që bën gati plumbnë
për të vrasë pllumbnë,
e zuri me dhëmbë
ndë një gisht ndë këmbë,
Gjatori unj kokën
për të kqyrë tokën,
pllumbi kupëtoi,
me vrap fluturoi
dhe u ngre ndë qiell.
Gjatori mbeti mbë diell.

1) duke me mos ditur not = duke mos ditur not.

2) q'e ka ndë tenxhere = që e ka në dorë, që e ka kollaj ta vrasë.

NJË ASTROLOG ¹⁾ QË RA NË PUS

Një ditë, nj' astrolog ra
ndë një pus, se nuk e pa.
Ata q'e panë,
van' e i thanë
për të qësëndisur
me shumë të shara:
«Mik o mëndjegrisur,
ti nukë sheh ç'ke përpara,
ndë mes të ditës ndë diell,
dhe do të shoç ç'ka ndë qiell?»
Shumë njers ndë këtë jetë
kupëtojnë shumë gjëra,
të bëra dhe të pabëra,
si mburren e thonë vetë.
Shohnë diallë dhe lugatnë,
shtien fall' e dinë fatnë!
Këto gjëra që tregojnë,
ku i gjejnë, ku i msojnë?
Dhe ndë ç'librë janë shkruar?
Nd' eshtra, ndë karta, ndë duar,
nd'yj që shikojmë ndë qiell,
te hënëza dhe ndë diell!
Mjaft, se tepëron inati!
Ç'është falli? Ç'është fati?
Ç'janë, ç'janë këto gjëra?
Janë gënjeshtër të tëra.

1) astrolog = fallxhi që hedh fall duke përë hyjet.

Tek një shpellë, ndë një ferrë,
 një ljepur mendonej thellë.
 Po ç'të bënte nd'atë shpellë
 vetëm e pa miq të tjerë?
 Ljepuri s'ish i gëzuar,
 ngulçonte,
 rënkonte.
 «S'është jetë për të rruar,
 thoshte, jeta që kam unë.
 Nga frika, s'bëj dot një punë;
 nukë ve dot gjak,
 se ha dhe fle pak.
 Kush trëmbet, kush më ka ngjarë,
 është vërtet për të qarë:
 nga frik' e shkretë
 numuron çapët,
 fle me sy hapët,
 me vesh përpjetë;
 dridhet si fletë
 kur vështron hijen;
 zoqtë që shkojnë,
 gurët që bien,
 fort e frikojnë,
 dhe merr ethe shtatë palë.
 Më thonë ca rrënjëdalë,
 këtë smundje ta shëroj
 dhe të bënem trim e burrë;
 po frika, shëronet kurrë?
 Dhe njerstë vetë, besoj,

1) kagëzoza = bretkoca.

se kanë si unë frikë».
Këto fjalë kur mbaroi,
pas një çike,
ljepuri një zë ndëgjoi
dhe vate nga vatra,
dolli, iku me të katra.
Shkon e breth
leth më leth,
brek më brek,
shtek më shtek,
ndë të mbjella,
ndëpër shpella,
ndëpër zall,
ndëpër ara;
gjen përpara
një moçal.
Ish një pellk me ujë plot,
ljepuri s'e shkoi dot.
Kagëzozat, kur e panë,
të tëra tok ndë pellk ranë
me rëmbim.
«Qënkam trim!
thirri ljepuri me gas.
Kagëzozat që më njojnë,
ikin dhe prapa s'vështrojnë,
nga frika se mos i vras!
Vanë të fshien ndë lumë.
Tani kupëtoi dhe vetë,
çdo frikaman mund të ketë
të tierë shokë në jetë
të kenë frikë më shumë».

GJELI DHE DHELPI

Një gjel plak këndonte
mbi një degë mollë,
dhelpira q'e dëgjonte,
«Mik, i tha me zë të hollë,
si vëllezër do të rrojmë
sot e tutje dhe ndë paq,
se nukë do të qërtojmë.
Zëmra tepër m'u kënaq,
kur msova sot këtë punë,
dhe me vrap erdha këtëunë.
Të ta them, që të mos ndruash,
të vesh, të vish tek të duash.
N'u gëzove si dhe unë,
mos mëno ¹⁾, të qofsha falë,
zbrit të të puth ndë ballë,
se kam pun' e do të shkoj.
Eja, mik, të të pushtoj.
Sot e tutje, besa-besë,
të kam vëlla.»
Kokoshi tha:
«Më të mirë lajme s'presë.
Gëzonem me të vërtetë
q'erdhe sot e ma the vetë.
Po shikoj
dy langoj
që vinë këtëunë
sot për këtë punë.
Prit të vinë t'i nderojmë,
të tërë tok të gëzojmë».

1) mos mëno = mos vono

Dhelpra tha: «Mbeç me shëndet!
Se mua puna s'më pret».
Dhe iku me bisht ndë shalë,
se qëllimi s'ju mbarua
si kish pandyer ndë ballë.
Po këndesi u gëzua
se i vate puna mbarë
dhe qeshi dhelprën e mjerë.

Kush gënjen me gënjeshtarë,
shokë, gëzonet dy herë.

KORBI QË DO TË SHKOJË PËR SHQIPONJË

Zok i Zotit Jupiter, ¹⁾
shqiponja një dash na merr.
Një korb i zi q'e kish parë,
pandehte se i kish ngjarë,
prandaj kërkonte të marrë
një dash tjetër për të çarë.
Për të ngrënë di e ha,
po si shkaba takat ²⁾ s'ka.
U ngre vate ndë një stan,
zgjodhi dashnë më të mirë:
ish kaq i majm' e i pirë,
sa për të bërë kurban.
«Nukë di kush të ka mëndur, ³⁾

1) Jupiteri ose Zeusi = i pari i perëndive.

2) takat = fuqi.

3) të ka mëndur = të ka dhënë sisë.

tha korbi, po je për mua»,
dhe me vrap ju afërua.
Po dashi kish lesh të dëndur
dhe të gjatë gjer ndë shesh:
kur u sul korbi ta zërë;
ju zunë këmbët ndë lesh
dhe nukë mundi ta ngrërë.
Dëm mundohet e ngulçon,
as q'e ngre, as q'e lëshon.
Korb' i gjorë, faqeziu,
qante me lot,
se s'iku dot
kur vate bariu
e zuri të gjallë.

Ç'na mëson kjo përallë?
Vetëvedin, mor të mjerë,
mos e mburrni, mos gënjeni,
se nuk jini si ç'pandeni,
burra trima si të tjerë.
Gjithë lulet erë mbanë,
po trëndafil nukë janë.

MILLONAI, 1) I BIRI DHE NJË GOMAR

Gjithë njerstë dinë,
përallat na vinë
nga Greqi e vjetër,
Po ndë këtë kopshtë, sado ta vjelç mirë,

1) millonai = mullixhiu.

me kujdes e me dëshirë,
mbeten rrush dhe për një tjetër.
Kurdoherë kanë dalë
shkronjëtorë të çkëlqyer,
përralla kanë rrëfyer.
Ndëgjoni këtë përallë
të gjat' e të gjërë,
që tha Malherbi një herë
te Rakani, ¹⁾ mik me kokë.

Këta të dy shokë,
vjershëtorë të ndëgjuar,
shetitnin një ditë, duke kuvënduar,
ndëpër vreshta, ndëpër ara.
«Mik, tha Rakani përpara,
shok me të vërtetë,
të lutem tregomë,
si mik këshillomë
ç'të punoj ndë jetë.
Ti më di kush jam
dhe gjënë që kam.
Të vete gjetkë? Të rri këtunë?
Apo nga mbreti të kërkoj punë?
Ushtar të vete për të luftuar?
Të rri pa martuar
apo të martohem?
Të tëra, them kur mendonem,
janë të mira për mua,
po s'mund të bëj si të dua.

1) F. de Malherbe dhe H. Racan = poetë lirikë francezë të shek. XVII.

Në shkallë që jam, me far' e me fis,
me miq, më të njohur, s'di si lipset bërë
të mund t'i kënaq të tërë».

Malherbi përgjigjet: «Mos u sëmëlldis,
kënaq botën gjithë. Po ndëgjo ndë ballë
të të tregoj një përallë.

Një millona me të birë
u nisnë për në pazar
për të shitur një gomar.
Që ta shesësh ca më mirë,
që të mos lodhet gomari,
e shpëtuan nga samari,
kur e lidhë mbi një tra,
e muar të dy ndë krah,
njeri pas, tjetri përpara.
Gjenë ndërper ara
një tjetr' udhëtar;
ky u tha,
kur i pa:
«Nga këta të tre nuk është gomar
ay që pandeni,
ndaj mos u gënjeni».
Millonai q'e ndëgjoj,
e mori vesh këtë fjalë
dhe me vrap, bashkë me djalë,
në shesh gomar' e lëshoi.
E zgjidhi nga druri,
përpara e vuri;
kur hipi të birë,
vetë me gas
dhe me dëshirë
u vete pas.

Do s'do veshgjati, shkon duke qarë,
 se i pëlqente mënyr' e parë.
 Tre njerës q'i panë,
 djalit i thanë:
 «Ti s'paske turp fare, nukë paske gjak!
 Zbrit nga gomari, t'ja hipij yt' at',
 q'është shumë plak».

Djali me inat
 zbret nga veshgjati, —
 ja hipën i jati.
 Më tutje gjenë tri gra,
 nga të tria njëra tha:
 «Mbytu, mbytu, millona,
 që shkon hipur si dhespot!
 Shiko, djali s'ecën dot
 ndë këtë rrëpirë».

Millonai plak
 gravet u dha hak,
 mori ndë vithe të birë.
 S'kishnë bërë njëzet çapë,
 poqnë të tjerë niers prapë.
 Një nga të tërë këta,
 kur i pa hipur, u tha:
 «S'kini turp, të turpëroni?
 Mos jini të dy të marrë?
 S'ju vjen rëndë që mundoni
 kaqë shumë sot gomarë?
 — Vanë mënd e mia, vanë!
 thotë millonai. Sot,
 kurkush nukë kënaq dot
 gjithë botën dhe babanë!
 Çdo njeri me mënd të vet ...

Tani gjë tjetër s'më pret,
nga gomari të zbres,
që të mos thyet në mes».

Pas këto fjalë,
hidhet ndë shesh
bashkë me djalë.

Gomari qesh,
se u lecu¹⁾ nga barra.

Vunë gomarë përpara,
vetë pas i venë.

Pa vatur në treg,
njers të tjerë gjenë
sipër tek një breg.

Kur u vanë pranë,
të tërë tok thanë:
«Shihni mëndjehollët,

shihni dy të marrë
që grisinë shollët,
kurcejnë gomarë,

se i kanë ngjarë»

U hoth e tha millionai!

«Vërtet jam gomar, për Zonë!

Tek un' është gjith' fai,
se kërkoj të bëj ç'më thonë.

Shani, qeshni sot me mua.

Sot e tutje, kurdoherë,
do të bëj vetëm ç'të dua,

jo si të duan të tjerë».

Dhe ti, mik, ashtu më rruash,
të bësh vetë si të duash:

ecë gjetkë, rri këtunë,

1) lecu = lehtësua.

lëfto a bën tjetër punë,
martoju, mos u marto,
shërbe dhe mbretinë, në do,
po sido që të punosh,
plot fjalë do të ndëgjosh.»

UJKU QË BËNET BARI

Thonë, një ujk plak një mot,
kur pa që nukë zij dot
si përpara dhën e dhi
ndën stan u vesh si bari.
Për këtë punë,
veshi një gunë;
nga një bri drëri,
një fyell bëri;
kërrabë bëri një stap ¹⁾
dhe në stan u qas me vrap.
Fatmirosh! — Bushtrat dhe qëntë,
bariu, dhitë dhe dhëntë
janë të gjithë në gjumë.
Që të zërë shtjerra shumë
dhe t'i shpjerë ndënë shpellë,
si bariu desh t'i ndjellë,
t'i zërë me dhunë
një nga një tek flënë;
po kur foli, prishi punë:
i kupëtuanë zënë.
Kur e ndëgjuan,
dhënt u trazuan,

1) stap = shkop.

qënt u lëshuan,
barinj^t u sgjuan,
ujkun e zunë të gjallë.

KAGËZozat ¹⁾ QË KËRKOJNË NJË MBRET

Kagëzozat mbret kërkojnë,
në liri s'duan të rrojnë.
Luten, falen me dëshirë
Zotit, për një mbret të mirë.
Perëndia i ndëgjon,
nga Qielli u dërgon
për mbret një tra.
Përdhe kur ra,
trënditi ²⁾ dhenë!
Nga frika, van' e u fshenë
kagëzozat ndë moçal.
Një kagëzozë guxoi,
pranë te mbreti qëndroi,
vate ju fal.
Mbreti qëndron rëndë,
me gojë s'i flet:
rri ndërtur ³⁾ si mbret
tek ka zënë vëndë.
Kaq i butë kur u suall,
gjithë kagëzozat duall
nga moçali dalngadalë.
Duke këcyer valle,

1) kagëzoza = bretkoca.

2) trënditi = tronditi.

3) ndërtur = shtritur.

guxuan e vanë
gjer te mbreti pranë,
hipnë mbi kurris.
Mbreti s'lëvis
as nuk flet.
Kagëzozat q'e shikojnë,
s'e peshojnë,
s'e nderojnë:
nga Zoti prapë kërkojnë
t'u falij një tjetër mbret,
të dijë të mbretërojë,
të mundij të kuvëndojë,
të madhojë mbretërinë
dhe të ndëgjonet ndë botë,
Zot' i math e fuqiplotë
u dërgon një ngjeraqinë.
Ky mbret i ri
ha njerst' e ti,
rron si Sulltani me gjak.
Kagëzozat, nga ky shkak,
te Zoti qahen, thërresën,
se një nga një do të vdesën.
Po Zoti u loth e pshoi:
tjetër mbret nuk u dërgoi,
po u tha me zëmërim:
«Fajnë sot e kini vetë,
se kërkuat mbret ndë jetë.
Kur bëtë këtë gabim
edhe s'qëndruat si jeshtë, ¹⁾
mbretn' e parë pse s'e deshtë?
Ish i urt' e zëmërmirë,

1) si jeshtë = si ishit.

u linte ndë paq, të lirë.
Sot mos qajni, mos thërrini,
të mbani mbretinë që kini;
si kini bërë, mos bëni,
djem e pleq,
se mos gjëni
një mbret tjetër më të keq».

DHELPA DHE CJAPI

Një mëngjes, pa gdhirë mirë,
dhelpa dhe një cja me brirë
shetitnin tok ndëpër ara;
kur gjenë një pus përpara.
Miqte tok brënda zbrinë,¹⁾
kërkuan ujë të pinë.
Kur pinë sa deshnë
ujë fort të ftotë,
dhelpa, duke kruar veshnë,
cjamin kthenet e i thotë,
që të mundij ta gënjejë:
«Qysh do të dalim këtejë?
Hipë, mik, mbi këtë gur,
ngre këmbët në këtë mur
dhe brirët përperjetë,
të ngjitem mbi kurris tënd,
të mund të dal nga ky vënd;
edhe kur të shpëtoj vetë,

1) zbrinë = zbritën.

po të punosh si të thashë,
do të të nxjerr pa dyshim».
Thotë cjapi kokëtrashë:
«Qënkej i zgjuar dhe trim,
Pasha Zonë, këtë punë
kurrë s'e gjejë dot unë.
Do të të kem ndë natyrë
për shëmbëll e për pasqyrë».
Me këtë mënyrë,
dhelpra jashtë dolli.
«Plastë dhija që të polli,
të rruatë mjekra!»
i tha cjamin dhelpra.
«Të keshë pak tru
dhe pak mënd të keshë,
nukë do të jeshë
te ky pus këtu.
Duro, paç uratë,
dhe mbeç me shëndet,
se çoku ¹⁾ kam për të vatë; ²⁾
dhe puna nukë më pret;
mënova ³⁾ shumë këtunë,
zorrët m'u shkundnë».

Miq, në çdo punë,
mendoni fundnë.

1) se çoku = se diku.

2) për të vatë = për të vajtur.

3) mënova = u vonova.

SHKABA, DOSA¹⁾ DHE MAÇJA

Ndë një hon²⁾ të thellë,
një shkabë kish pjellë,
majë lisit, ndë fole;
dosa kish pjellë përdhe,
maçja kish pjellë ndë mes.
Të tri mëmat shkonin mirë;
pa qartë³⁾ dhe pa trazirë,
Maçja ngjitet një mëngjes
ngjer te shkaba me rëmbim,
dhe i thotë duke qarë:
«Motrë, dosa na bën varrë,
çunat s'na kanë shpëtim!
Shiko dosa se ç'punon,
bythë lisit po rëmon,
rrënjët e lisit zbulon.
Sikur të fryjë pak erë,
lisi përdhe do të bjerë,
dhe djemtë që kemi bërë
do të vriten që të tërë!
Kur të mos kemi një djalë,
ç'e duam vedin të gjallë?»
Kur mbaroi këto fjalë,
maçja zbriti në shesh
dhe dosës i tha në vesh:
«Të lutem, për Perëndi,
të mos largohesh këtej!
Ndëgjova me vesht'e mi,
shkaba do të të rrëmbejë

1) dosa = femra e derrat.

2) hon = greminë.

3) qartë = grindje.

djemtë! T'i hajë kërkon,
se fort të majm' i shikon,
Mike, mos më tradhëtosh,
te shkaba mos më tregosh,
se ja punova me dhunë.
Sikur të më kupëtojë,
s'ka dyshim që do të dojë
të nxjerr' inatnë tek unë».
Këto tha maçja, pastaj
vate ndë fole të saj
Nga frika, shqiponj' e ngratë
rri ndë fole dit' e natë,
bashkë me fëmijë,
të mundij t'u ndijë
lisi kur të bjerë.
Po dhe dos'e mjerë
qëndronte në prak,
nga shkaba ruhet me hak
dhe s'largohet nga fëmia.
Pas ca dit, për këtë shkak,
gjithë ngordhë nga uria:
dosa me derrat,
shkaba me zoqtë,
vanë të mjerat!
Maçja për maçoqtë
këtë qëllim kish, —
u ngopnë me mish.

M'i lik, m'i keq dhe m'i ndyrë
është sot ndë këtë botë
një mik që ka dy fytyrë:
mos e besoni ç'u thotë,

mos u gënjeni me fjalë,
po kupëtoni në ballë
qëllimnë që ka të fshehtë;
të tjera thotë me gojë,
të tjera do të punojë,
të na bëjë varrë vetë.

I DEHURI (CAROSHI) DHE GRUAJA E VE

Çdo njeri ka një zakon,
ngjer sa vdes me këtë rron;
si ç'na thotë kjo përallë,
është e vërtetë kjo fjalë.

Ishte një njeri një herë,
që pinte raki dhe verë:
pinte, pinte dit' e natë,
prishte shënden' e paratë
dhe trutë që kish ndë kokë,
se për të pirë s'kish shokë.
Një ditë, themi, njeriu
u dej nga vera që piu,
u këput e ra përdhé,
se la mëntë ndë shishe:
ishte dehur kaqë shumë,
sa ra i vdekur ndë gjumë.
E shoqja ndë një qilar
e shpu, e nderi te sheshi,

si një të vdekur e veshi.
 Qilari dukej si varr:
 dy qirinj ndrinin mi tokë,
 një në këmbë, një mi kokë, —
 Shokë, se ç'punon një grua!
 I dehuri kur u zgjua,
 kur pa qirinjtë, savanë,¹⁾
 thirri: «Ç'është kështu me mua?
 Ndë këtë varr pse më lanë?
 Mos vdiqa kur piva dje?
 Mos lashë gruan të ve?»
 E shoqja ngjeshur me breza,
 hyri veshur me të zeza;
 ndë një dorë kish
 një sahan me mish;
 ju qas dhe ngriti savanë.
 I shoqi, kur e pa pranë,
 u tremb, se s'e njojti dot,
 ju mbushnë sytë me lot
 dhe thirri: Ç'është kjo punë?
 Kush je ti që rri këtunë?
 Mos erdhe shpirtin më more?»
 Zonja tha: «Jam shërbëtore.
 Këtu Djalli mbretëron,
 të vdekurët zot e kanë;
 ndërper varre më dërgon
 t'u shpie gjellë të hanë,
 se pa ngrënë nukë rrinë».
 Miku tha: «Për Perëndinë,
 s'u shpie gjësend të pinë?»

1) savani = çarçafi me të cilin mbështjellin të vdekurin»

PËRDHESI ¹⁾ DHE MERIMAGA

Merimaga me përdhes'
ishnë mbyllur ndë një thes,
po djalli vate t'u thotë:
«Nga ky thes do t'u nxierr unë
dhe do t'u dërgoj ndë botë,
që të bëni ndonjë punë
dhe ta kini për lëvdatë,
të mundoni dit' e natë
gjithë njerstë, burrat, gratë.
Shikoni këto shtëpira,
ca të liga, ca të mira,
zgjidhni vëndë q'u vjen mbarë».
Merimaga tha më parë:
«Do të vete ndë qytet,
ndë një pallat, tek një mbret».
Përdhesi tha: «Pallat s'dua,
se ky vënd s'është për mua,
ven' e vinë kurdoherë
shëronjës dhe njers të tjerë.
Do të rroj ndë një shtëpi
të varfër, shtruar me kashtë,
të mos më kërrej në jashtë».
Me vrap vete hap një derë,
hyri tek një plak i mjerë,
që s'kish as dhëmball' as dhëmbë:
e zu përdhesi ndë këmbë
me gjithë fuqi që pati,
dhe me vete tha: «Këtejë
s'vjen kurkush të më kërrejë; ²⁾

1) përdhesi = sëmundje që paralizon pjesë të trupit.

2) të më kërrejë = të më nxjerrë jashtë.

ç'kërkton këtu Hipokrati?»¹⁾
 Po merimaga kish vatë
 ndë një pallat: q'atë natë,
 ndë një dhomë zu të tjerrë,
 bëri një fole të gjërë,
 sikur ish pallat' i saj.
 Një shërbëtor më pastaj
 vete fshi dhomën të tërë,
 prish folenë që kish bërë.
 Merimaga përsëri
 bën fole ndë tjetër bri.
 Prapë fshiu shërbëtori
 dhe me fshesë jasht' e nxori.
 Merimaga ndë pallat,
 si nukë gjën dot rehat,
 ngrihet e vete ndë fshat.
 Me përdhesnë kur u poqnë,
 thanë të ligat që hoqnë,
 Përdhesi më tepër qahet
 dhe nga plaku do të ndahet,
 se ky punon dit' e natë,
 kur mes hat, kur me sëpatë,
 kur vete nd'arë të mbjellë
 kur ndë vështë për të vjelë.
 Për një njeri që punon,
 thonë se përdhesi shkon.
 Kur sosnë këtë kuvënd,
 të dy shokët vunë mënd
 dhe ndërruan prapë vënd:
 merimaga, nga oxhaku,
 hyri ndë shtëpi te plaku,

1) Hipokrati = mjeku i famshëm i Greqisë së vjetër.

këtu për jetë qëndroi;
fshesa kurrë s'e trazoi,
se plaku, për Perëndinë,
s'kish nga të fshijë shtëpinë.
Përdhesi tek një dhespot
ngrihet e vete një natë,
e bën të mos lozë dot
nga shtrat'i gjër' e i gjatë.
Dëm zën' e fërkojnë gratë,
kot e shtypin, se përdhesi
s'do të largonet nga mesi.
Tani shokët u gëzuan,
se, që ditën që ndërruan
vënd, kurrë nuk u trazuan
dhe shkuan jetë të mirë,
pa rrezik dhe pa trazirë.

UJKU DHE LEJLEKU

Ujku, thonë, në vënd tënë
nukë nginjet duke ngrënë.
Një ujk, vetëm e pa miq,
hëngri shumë, sa desh vdiq:
një dit' i mbeti një ashtë¹⁾
në gryk' e s'mund ta nxirr jashtë
Thërrit, bërtit ndë një breg,
ulërinte, tunte vëndë;
e ndëgjoi një lelek,

1) ashtë = kockë.

për ujkun i erdhi rëndë:
me qeft të gjatë që kish,
i nxorri ashtën pa mish.
Pastaj, për këtë shërbim,
nga ujku deshi pagim.
«Pagim, tha ujku, kërkove?
Ç'të lipsen të tilla fjalë?
Nuk është mjaft që shpëtove
nga goj' e ujkut i gjallë?
Guxon e kërkon pagim!
Çporru! Ndryshe s'ke shpëtim »

NJË LUAN I VRARË NGA NJË NJERI

Një piktor fort i ndëgjuar,
në kartë kishte piktuar
një luan të math, të ri,
të vrarë nga një njeri.
Gra e burra van' e panë
dhe përqeshnin me luanë.
Shkoi një luan i gjallë
dhe mbaroi këtë qartë,¹⁾
duke thënë këto fjalë:
«Vërtet, një luan ndë kartë
mundet e vritet kollaj,
me faj në qoft' a pa faj.
Piktori bëri si deshi
dhe më duket se u qeshi

1) qartë-a = grindje.

me një të madhe gënjeshtë:
t'ish një luan piktor mjeshtrë,
do të na lëvdonte
dhe do t'u tregonte
të poshtrë, pa gjak,
dhe do të kish hak».

DHELPRÄ DHE RRUSHTË

Dhelpr' e mallëkuar
doli nga shtëpia;
e kish marrë uria,
vate për të gjuar.
Sheh një pjergull me rrush plot,
bën t'i zër' e s'i zë dot,
dhe si s'mundi dot t'i zërë,
tha: «Qënkan rrush të pabërë,
s'janë, jo, s'janë për mua,
nuk i dua, nuk i dua,
le t'i hajë ndonjë tjetër».
Ç'mund të thoshte zonja dhelprë?

PATA DHE GJELLËTORI ¹⁾

Rosa dhe pata,
si dy kunata,
ndë një kopshtë ven' e vinë,
bashkë han' e bëjnë not.
I kish blerë një dhespot
që të dyja bashkë:
patën duante ²⁾ ta hajë
dhespoti për pashkë,
rosën duante ta mbajë
ta ketë për bukuri
brënda ndë shtëpi tek rri.
Po gjellëtori
piu një natë,
u dej i gjori
dhe mori rosën për patë,
do ta therrte që ta haj.
Rosa s'priti,
thirri, briti,
ju lut në gjuhë të saj
të mos e therrij pa faj.
Gjellëtori, kur ndëgjoi,
me vrap rosën e lëshoi,
se gabimn' e kupëtoi
dhe nukë deshi të vrasë
një zok që dinte të flasë
dhe të lutet me dëshirë.

Kurdoherë fjal' e mirë
në njers me mënd
ka zënë vënd.

1) gjellëtori = gjellëbërësi.

2) duante = donte.

UQRËT DHE DHËNTË

Ndë një stan, ndë një vërri, ¹⁾
uqrët lidhë miqësi
me shtjerra, me dhën, me dhi.
Të dy palët fitim kanë:
vërtet uqrët berra hanë,
kur u vete puna mbarë,
po sa uqrë janë vrarë
nga barinjti e mallëkuar
kur u bienë ndër duar?
Që të mos ndërrojnë fjalët,
dhanë penk që të dy palët
për të rojtur ndë qetim: ²⁾
uqrët, për këtë qëllim,
lanë këlyshët te dhëntë,
dhe këto u dhanë qëntë.
Pesë muaj nukë shkuan
dhe këlyshët u madhuan
dhe uqrë të fort u bënë.
Një ditë s'ishnë baritë
ndë stan; uqrët atë ditë
gjithë tok hidhen e zënë
sa mundin nga bagëtitë,
dhe i shpien duke çjerrë
tek presën shokët e tjerë,
brënda ndë pyll, tek një breg.
S'shpëtoi asnjë shelek ³⁾
nga të tëra dhit' e dhëntë!
Nukë shpëtuan as qëntë,

1) vërri = kullota dimrore.

2) qetim = qetësi.

3) shelek = shqerrë e rritur.

se i mbytnë gjakëtorët
ndë gjumë gafil,¹⁾ të gJORËT;
asnjë nuk mbet i gjallë!

Shokë, me këtë përallë
duhet që të kupëtojmë
se armiku s'bëhet mik,
dhe njerin' e lik
të mos e besojmë,
se na punon varrë
kur i del për mbarë.

LUANI PLAK

Një luan në pleqëri
qahej se s'kishte fuqi.
Kur ish i fort e i ri,
s'i dil dot njeri përpara;
po gjithë kafshët tani
ven' e ngasin me të shara.
Përpara qaset një kalë
dh'e godit me shkelm ndë ballë
më të madhen egërcirë;
një dem e godit me brirë;
një ujk i qaset ndë këmbë
dhe ja xugavit²⁾ me dhëmbë.
Mbret' i shtasavet s'ka shpresë,
s'ka takat as të thërresë,

1) gafil = papandehur.

2) xugavit = kafshon.

lutet e falet të vdesë.
Vate dhe një gomar pranë,
qesëndiste me luanë
duke ndërsyer për qartë. 1)
«Të martë dreqi, të martë!
tha luani. Nukë presë
të të shoh të qeç me mua!
Kush gjegj të sharat e tua,
vdes dy herë, besa-besë!»

Shokë, këmba po t'u shkasë,
i mir' i lik do t'u ngasë
dhe do t'u shtyjë më shumë,
që të bini çpejt ndë lumë;
se qerozi kur zë lesh,
me gjithë botë përqesh.

NUS' E LALËS NDË NJË HAMBAR

Në fund të shkalës, 2)
tek një qilar,
hyn nus' e lalës
ndë një hambar,
se gjeti vërë,
Ndënji një javë të tërë,
hëngri sa deshi, prandaj
u fry, u trash e u maj;
duke ngrën' e duke pirë,

1) qartë = zënje.

2) shkalës = shkallës.

u bë si kapuç në hirrë,
nga ç'ish përpara si ngjalë.
Kur gjegji një zë te muri,
nga frika deshi të dalë,
po vrim' e shkretë s'e nxuri.
Nukë dinte nga të vejë,
«Kur hyra, shkova këtejë!
thoshte me vete të saj.
Sot, pse nukë mund të shkoj?
Ku të futem të shpëtoj?»
Një mi, kur e pa tek qaj,
i tha: «Këtejë s'del dot,
se tani ke barkun plot.
Si ndodhej ti këtë herë
janë ndodhur dhe të tjerë;
kanë hyrë, s'kanë dalë.
Po s'të duhen këto fjalë,
se je vetë në rrezik.
Ndëgjo të të them, or mik:
nga vrima në do të shkosh,
duhet të jesh me bark bosh».

MAÇOKU DHE MIU PLAK

Tregojnë se një maçok
ish i fortë sa s'kish shok.
Kur dilte që të gjatonte,¹⁾
asnjë mi nuk i shpëtonte.

1) gjatonte = të bënte gjah, të gjuante.

Minjt e gjorë desh u shuan.
Ca të pakë që shpëtuan,
ndër vrimë rrinë të tërë,
nga frika se mos i zërë.
Maçi përgjon nat' e ditë,
po s'dalën nga vrima mitë,
rrinë ndënë prak.
Po, për këtë shkak,
maçi një mëngjes
shtiret sikur vdes,
dhe në një litar
nga këmbët u var:
as tundet, as flet.
Mitë, me të parë,
pandejnë vërtet
se macokn' e kanë vrarë.
Ndë dhomë, guxojnë
qasen me ngadalë,
nga gazi këndojnë,
dhe këcejnë valle.
I vdekuri qeshi,
u ngjall si Lazari
dhe ra nga litari
zuri minj sa deshi.
Ata që shpëtuan,
me vrap u larguan.
«Tekdo që të vini,
thosh maçi me vete,
shpëtim nukë kini,
se di marifete,
di të them të rrëme,
di të bëj llagëme».

Maçi një të diel
u lye me miell.
Minjtë këtë dhunë
nuk e kupëtuan
dhe iu afëruan,
një nga një u zunë.
Një mi plak me mënd,
i ditur, i vuar,
s'u qas nd'antë vënd.
«Të kam kupëtuar
dhe miell në ke;
sot s'më gënjen dot, s'më qesh,
dhe thes me miell të jesh;
nukë qasem, mos ki shpresë,»
tha miu dhe iku.
Armikut, kush s'i vë besë,
shpëton nga rreziku.

MIZA DHE MILINGONA

«Zonja milingonë,
tha miza një herë,
rrëfemë, për Zonë,
për ç'punë ke lerë?
Qysh të duronet kjo jetë?
S'të bëri Zoti si mua.
Shiko, shiko si rroj vetë;
vete tekdo, bëj ç'të dua;
ngrihem ndë qiell përpyetë,

ngjer te Zoti Jupiter!
Kudo që të vete kam nder,
rroj me gas.
Kush më flet?
Në pallas,
tek një mbret,
vete, vi,
ha dhe pi.
Po të dua,
vete rri
tek një grua,
se më do për bukuri;
për emër të Perëndisë,
i qëndroj në sisë,
në gush' e në faqe,
që mban erë manushaqe.
Po ti krimb i mallëkuar,
ecën me këmb' e me duar,
bën fole
nënë dhe,
s'mund të ngrihesh lart as lark,
se shkarrëzehej me bark!
S'mbararisej ¹⁾ dot me mua.
— Zonjë, the sa t'u tha gjuha.
Për fajet tona,
tha milingona,
u tunde, u shkunde,
u mburre sa munde,
po s'je si ç'panden.
Vërtet vete, vjen
mike, tek një mbret,

1) s'mbararise = s'barazohe.

po njeri s'të pret,
kush të sheh të vret.
Në këtë natyrë
s'ka gjë më të ndyrë.
Të kanë për tmer
nga qelbi që nxjerr.
Tek një çupë kur qëndron,
ti mburrej q'e zbukuron,
po sa herë të kam parë
në derra dhe në gomarë?
Përkundrë, shiko ç'bëj unë:
nukë rri kurrë pa punë.
dhe sa të rroj
do të punoj.
Në dimër, kur fryn veriu,
tëbora s'më trëmb, as shiu,
Rri ha, pi
ndë shtëpi,
si mbret jam,
plot gjë kam.
Mizat vdesën nga uria.
Ç'të duhet bukuria?
Pusho, se ti s'më shan dot!
Ç'e do bukurinë molla,
kur ka mbrënda krimba plot?
Kaqë dita, kaqë fola;
të falem, mbeç me shëndet,
iki, se puna s'më pret;
duke folur me ty, kurrë
s'mbushet hambari me grurë».

KOPËSHTORI

Një njeri, lindur për shat,
kish një kopshtë ndë një fshat
mjaft të bukur e të math,
të qerthëluar ¹⁾ me garth.
Nga kopshti s'dilte,
punonte vetë,
gjithënjë mbillte
lakra, lëpjetë,
kunguj të gjatë,
hudhra, salatë,
qep' e prasë sa të doje,
çdo lule që të kërkoje.
Mbrënda ndë kopshtë të gjërë,
hyri një ljepur një herë.
Kur e pa fshatari,
nga frika mos prishet bari:
edhe kopsht' i tërë
me qep' e me prasë,
ljepurin deshi ta vrasë,
po s'mundij ta zërë,
ta thyej në mes.
Ngrihet një mëngjes,
te nashai vete qahet:
«Një ljepur nga kopshti s'ndahet
dhe më prish lakrat me prasë,
tha duke qarë me lot.
Desha ta vrasë,
s'e zura dot.
Është dreqi vetë.

1) qerthëluar = rrethuar, qarkuar.

— Dhe djall të jetë
kam langoj plot,
s'më shpëton dot,
do të vi ta zë të gjallë!
— Po kur? — Që sot!»
Pashai, pas këto fjalë,
ndë pallat nukë mënoi,
hipi kalit edhe shkoi,
mori pas tre shërbëtorë,
gjithë me pushkë në dorë.
Te kopështari kur vanë,
kërkuan të hanë.
Fshatari, kish, s'kish,
u dha mjalt' e mish
dhe një lakruar, që kish gatuar
me mjeshtëri
e bij' e ti.
«Paske çupë, mashalla!
tha pashai kur e pa.
Kur ta martojmë,
do të këndojmë.
Si kjo s'kam parë,
lum kush ta marrë».
E vuri pranë;
me këmb' e shkelte,
i puthte kranë,
e përkëdhelte,
duke pirë verë.
Kur piu sa deshi,
pashai u ngre nga sheshi
me gjithë trimat e tjerë.
Hipur në kalë,

hyri në ballë
ndë kopshtë, për të kërkuar
ljepurin e mallëkuar
që kishte shkuar
dhe nuk e panë.
U prish kopshti anëmbanë:
pashai me shërbëtorë
bënë, vetëm në dy orë,
dëm të math për kopështorë.
«Kaqë, dëm, me të vërtet',
thosh fshatari, po ish vonë,
gjithë ljepuret, për Zonë,
s'e bëjnë ndë dyqind vjet».

Shokë, lipset të dimë,
se me zakonet që mbanë,
njerst' e mëdhenj sot kshtu janë;
ata q'u kërkojnë ndihmë
humbasën gjënë që kanë,
edhe shumë herë
humbasën dhe nderë.

MINJTË DHE NUSËT E LALËS NË LUFTE

Nusëz' e lalës, mos qëntë,
do minjt' e mjerë
si ujku dhëntë.
Minjtë, një herë,
bashkë me mbrenë,
në këmb' u ngrenë,

për luft' u nisë,
 se u besdisnë. ¹⁾
 Nuset e lalës
 në luftë vanë,
 dhe, fund i fjalës,
 që të dy palët
 përpoqnë pallët.
 Për këtë shkak,
 u derth plot gjak.
 Të zestë mi
 lëftuan mirë,
 me trimëri
 dhe me dëshirë,
 po mbarë s'vanë,
 se shumë u vranë.
 Del miu mbret,
 thërret, bërtet
 tok me të parët,
 mburrin ushtarët, —
 këta s'qëndrojnë:
 ikë kish ikë,
 që të shpëtojnë,
 se muar frikë.
 Minjtë të tërë
 iknë, shpëtuan,
 se mund' e shkuan
 vërë mbë vërë. ²⁾
 Po vetë mbreti
 i vrarë mbeti.
 Dhe pashallarët,

1) bezdisnë = mërzitën.

2) vërë mbë vërë = vrimë më vrimë.

princrët, të parët,
si dhe bejlerët;
vdiqnë të mjerët
me shumë shokë.
Vrimat s'i nxenë,
se kanë vënë
brirë mbi kokë,
armë të rënda,
folla t'ërgjënda, ¹⁾
për të dukur
njers të bukur,
bura trima,
për të frikuar armiknë.
Minjt e vegjël kollaj iknë
ndëpër vrima,
tek u futnë,
kur u muntnë,
ndaj s'i zunë.

Në çdo punë,
të vegjit ²⁾ janë të çpejtë.
i vogëli tekdo shkon;
për të mëdhejtë
fjala ndërron.

1) folla t'ërgjënda = mburoja.

2) vegjit = vegjëlit

MAJMUNI DHE DELFINI

Grekrët e vjetër, vërtet,
kur bënin udhë ndë det
dhe vinin tek i shpij era,
mirnin pas kafshë të tjera,
qën, maç, pula dhe majmunë.
Një ditë, ndë një fortunë,
një gjemi ¹⁾ u ndoht ndë det.
Ndë këtë të math rrëmet,
ania, kush ta kish parë,
dukej si një koqe arrë,
dhe njerstë që kishte brënda
hoqnë mundime të rënda,
se kur hynë
desh u mbynë,
po delfinët i shpëtuan
nga ky rrezik.
Delfinët njerin' e duan,
e kanë mik.
Po të besojm' istorinë,
Dhjatën e vjetër ²⁾ dhe Plinë, ³⁾
delfini, si tham' më parë,
shpëtoi njerstë pa dhunë ⁴⁾. —
(Nd'Athinë ngjau kjo punë.)
Do t'shpëtonte dhe majmunë,
se për njeri e kish marrë:
e ngarkoi mbi kurris
dhe për në Pire ⁵⁾ u nis,

1) gjemi = anije.

2) Dhiata e vjetër = libër fetar që flet për krijimin e botës,
sipas botkuptimit fetar.

3) Plini = historian latin.

4) pa dhunë = pa bërë keq.

5) Pire = liman grek afër Athinës.

i lehtë si kashtë,
po, pa dalë jashtë,
delfini qëndron ndë det
dhe majmunit i flet:
«Mos je ng'Athina?» i thotë.
Ju përgjegj: «Ng'Athina jam,
farefis dhe miq plot kam,
të pasur e fuqplotë.
Mik, po të kesh nonjë punë,
të lutem të vish tek unë
të ta mbaroj, pa dyshim,
se jam i madh ndë vënd tim:
në shkronjën fjala,
më pret palla».
Delfini, kur e ndëgjoi,
me zëmër e ngjatjetoi.
Duke afëruar dhenë,
e pyet në nje Pirenë.
«Pirenë s'njo, trim me fletë»,
Jemi miq me të vërtetë»,
tha majmuni me të parë,
se Piren' e kishte marrë
për njeri! Ata që s'dinë
marrën Vlorën për Janinë,
bëjnë sikur kupëtojnë
dhe s'dinë se ç'kuvendojnë.
Delfini, kur e ndëgjoi,
ktheu kokën e vështroi,
dhe kupëtoi
që kërkonte
të shpëtonte
jo një njeri, po një shtasë

Që ta vrasë,
peshku s'pret:
lëshon majmunë ndë det.

NJË NJERI DHE KONISM' 1) E DRUNJTË

Ish një njeri,
kish ndë shtëpi
një Shënjt të drunjtë me bojë,
me sy, me vesh' e me gojë.
Kandilja me vaj
digjej nat' e ditë,
ndrinin qiritë.
Me faj, pa faj,
lutej duke qarë
dhe i falej. Kshtu punojnë
gjithë njerstë që besojnë,
që t'u vejë puna mbarë,
të gëzojnë,
të fitojnë,
plot para.
Vërtet konisma vesh ka,
po nukë ndëgjon.
Besniku rënkon,
se shikon xhepnë të thatë;
konisma nuk e kujton:
kot i falet dit' e natë
me shpresë dhe me dëshirë,

1) konizma = ikonë, figura shejtësh të pikturuar ose të gdhendur në dru.

që t'i vejë puna mirë.
Duke blerë vaj, qiri,
të mjerit njeri
ju sosnë paratë:
drur' i shënjtëruar
e kish varfëruar.
Besniku merr një sëpatë
nga inati, një mëngjes,
thyen konismën në mes!
Gjetë brënda plot para!
Këto, kur i pa,
u çudit e tha:
«Kur të besojë
dhe të nderojë,
kur të silleshe besnik,
ti më silleshe i lik,
gjithënjë më varfëroje,
bëje sikur s'më ndëgjoje,
ndaj fajn' e ke vetë.
Je, me një kuvënd,
si ca njers në jetë
që s'venë dot mënd
pa rrahur, pa vrarë.
Sa të falesh duke qarë,
sa të luteshë më shumë,
gjëndeshë lum' e për lumë,
i varfër, i ngratë,
dhe s'gëzojë dot.
Bëra mirë sot
që të çava me sëpatë».

SORRA QË NISËT ME PËNDËT
E PALLOIT ¹⁾

Në buzë të një përroit,
një sorrë gjen tek një shesh
shumë pendë të palloit:
i merr e i vesh
me vrap; më pastaj,
vate të lëvdonet
të shoqet e saj,
dhe t'u përgëzonet.
Pallonjtë q'e panë,
s'e qasnë, s'e lanë;
desh e copëtuan,
kur e kupëtuan;
dhe sorrat e tjera
kur e panë, qeshnë,
për shoqe s'e deshnë,
e lanë te dera.

Si sorra sot
gjënden njers plot:
shkronjëtorë plot kam parë,
vjershëtorë të ndëgjuar,
po veprat që kanë shkruar
nga të tjer' i kanë marrë.
Më vjen të shaj këta shkrime,
po nuk është puna ime.
Shini, shini gratë,
nisen dit'e natë,
lahen e lyhen me bojë:

1) palloj = shpend i bukur me një pupul të gjatë mbi kokë.

një qind vjeç grua,
pa dhëmbë ndë gojë,
vishet si pallua
dhe për çupë do të shkojë,
nxin leshrat, i bën si pisë;
ajo që nukë ka sisë,
mbush gjinë me lesh, për Zonë,
që të thonë,
kur ta shonë:
«Qënka, për të dukur,
grua fort e bukur».

DEVEA DHE BUTE ¹⁾ ME UJË

Burr' i parë
që ka parë
një deve
përmbi dhe,
nga frika mbase ka shkuar;
po një tjetër ka guxuar,
devenë ka zënë,
kapistr'i ka vënë.
Çdo gjë, me një fjalë,
na manit në ballë; ²⁾
po ta shohmë shumë herë,
nukë na frikon,
së bënet zakon.

1) buti = një vozgë e madhe që shërben për të mbajtur djathë, turshi, ujë etj.

2) na manit në ballë = na mahnit ose habit në fillim.

Ndë det të gjërë,
ca njers diç panë:
të tërë thanë
se ish anie;
deti e shpie
afër me bujë,
Kur vanë pranë,
këta njers panë
vetëm një bute me ujë.

Këjo përall' është e vërtetë
për ca njers në këtë jetë:
për së largu, kur s'i njonë,
duken çoç janë;
kur qasen pranë,
s'janë gjë fare, për Zonë!

KAGËZOZA DHE MIU

Kush rrëmon në këtë jetë
varr' shokut, bie vetë.
Minjtë kreshmë¹⁾ nukë mbanë,
as agjërojnë:²⁾
kur kanë, hanë.
Si na tregojnë,
një mi gjeti nëpër ara
një kagëzozë përpara,
ndë një moçal.

1) kreshma = koha kur të krishterët besnikë nuk hanë bulmet e mish.

2) agjërim = të mos vënit në gojë disa të ngrënave për një kohë të caktuar.

Kagëzoza kur e pa,
miut ju fal,
ju qas pranë dhe i tha :
«Mirëdita, zoti mi,
urdhro të vish ndë shtëpi,
se kam të madhe gosti.
— Do të vi, pse të mos vi,
thotë miu, po s'hyj dot
ndë moçal, se s'bëj dot not,
ndaj bjerma drekën këtunë.
— Mos ki frikë kur jam unë,
se me shëndet do të vemi.
Të shoç zakonet që kemi,
të shoç plot vënde të huaj,
të shikoç se si rron bota,
të bësh ca banja të ftota
tani që bën shumë vapë.
Kur të kthenesh në fshat prapë,
kur të dalç prapë mbi tokë,
do të munç të flaç me shokë
për gjëra që s'shonë kurrë.
do të dukesh trim e burrë.
Nukë mbytej, mos ki frikë;
qasu tek unë një çikë».
tha kagëzoza me gas.
Miu vu bes' e ju qas,
po kagëzoza pastaj
e lidh ndë këmbë të saj
dhe me vrap ndë moçal vete,
duke menduar me vete :
«Të kam ndër duar,
më vure besë,

për të shpëtuar
nukë ke shpresë.
Je gjithë dhjamë
dhe fort i njomë,
kur të të hamë
do të të shomë!»
Miu në det,
thërret, bërtet,
i lutet, shumë uron.
Ajo bën sikur s'ndëgjon;
lëpin buzët, kur mendon
që do ta hajë në gjellë;
rend ta heqij ca më thellë
ndë moçal, ndë fund.
Miu me sa mund,
hyn e del mbi ujë,
dhe, në këtë bujë,
fluturon një ngjeraqinë,
lëshonet e grabit minë
me kagëzozën e shkretë,
që qe lidhur vetë
në bisht të miut me dhunë.
Zogu, kur pa këtë punë,
në një shkëmb vate, ndë majë,
me gas qëndroi të hajë,
kur pa që kish
peshk edhe mish.

Pabesia, djallëzitë,
prapësitë, ligësitë,
janë fajet e njeriut;
kush i bën, ja bën vetiut.

KAFSHËT DËRGOJNË PESHQESH TE LEKA I MATH

Leka i math, trim me mënd,
u ndëgjua në çdo vënd:
nukë kish shokë të tjerë,
se kish baba Jupiterë,
trim e burrë që kërkonte
gjithë botën të zotonte.
Këtë qëllim kur ndëgjuan,
gjithë kafshët u frikuan:
në luftë kush mund të dalë,
kush qëndron ballë për ballë,
me të bir'e Perëndisë,
me mbretin'e Maqedonisë?
Që ta marrën me të mirë,
nga rreziku të shpëtojnë,
kafshët, në një shkretëtirë,
u mblodhë të bisedojnë,
u menduan t'i dërgojnë
ergjënd, ar edhe të fala.
Për këtë punë
zgjodhë majmunë,
q'është m'i zoti nga fjala,
pastaj ngarkuan me ar
një mushkë dhe një gomar
dhe një deve dhe një kalë;
majmuni vinte në ballë,
Tek një vënd, tek një livadh,
poqnë një luan të math.
«Mirëdita, tha, qysh ini?
Te Leka i math në vini,

gëzohem q'u poqm' këtunë,
se atje vete dhe unë.

Bashkë te mbreti të vemi,
t'i falim plaçkat që kemi,
t'i themi të mos na ngasë,
në luftë të mos na vrasë,
të na ketë miq për jetë,
që ta dojë Perëndia.

Mirri dhe parat'e mia,
se nukë mund t'i ngre vetë.

Për të mirën tuaj,
ngarkoni paratë,
që të mund t'u ruaj
udhës dit'e natë,

se në na dalçin armiq,
hajdutë dhe njers të liq,
duhet të jem i çkarkuar
dhe gati për të lëftuar».

Deshnë s'deshnë, që të pesë
luanit i dhanë besë,
bashkuan paratë,
muarr udhë prapë.

Një ditë në vapë,
gjenë një fushë të gjatë
plot me derra
dhe me shtjerra
në një stan.

Kur i pa zoti luan
shtjerrat, u shtir i sëmurë.
«Më dhemb barku, tha luani,
më digjet koka si furrë!
Mos më flisni, mos më ngani!
S'kam qënur kurrë si sot.

Më tutje nukë vi dot.
Ç'pësova sot unë!
Mos pasha nakar! ¹⁾
Do të rri këtunë,
të gjej nonjë bar.
Bobo! se ç'më gjeti!
U lutem, për Zonë,
mos humbitni kohnë,
po shkoni te mbreti.
Më paç' ura'ë,
kthemëni paratë,
se mund të më duhen,
miq, për nonjë punë».
Maimuni me shokë ruen
mos pësojnë nonjë dhunë,
no nukë shpëtuan,
demnë s'e mërguan:
luani me thonj të gjatë,
u mbajti gjithë paratë!
se parai ²⁾ pjell paranë,
thosh luani kokëtroshë.
Kush kundërshton me luanë,
q'është i fort' e i shëndoshë?
Me njerst' e mëdhenj ngahera,
gjithë fjalët i merr era.
Nga frika, kafshët e tjera
asnjë fjalë nukë thanë.
Për këtë shkak,
te Leka i math kur vanë,
i kallëzuan luanë,
Po Leka nuk u dha hak.

1) nakar = cmir.

2) parai = paraja.

Shokë, me zakon që kanë,
luani s'trazon luanë,
hajduti s'trazon hajdunë,
ndryshe s'mbarojnë dot punë.

KALI DHE DRERI

Mos pandeni, mor të mjerë,
se kuajtë kanë lerë
për të shërbuar njerinë.
Për Perëndinë,
prej së pari,
kali, mushka dhe gomari
të lirë ndë male rronin,
hanin, pinin tek të donin;
s'kish samar
për gomar,
dhe për kalë
s'kishte shalë;
kapistra me fre
nukë kishnë dalë.
Një ditë, një dre
u zu me një kalë
në një fushë që kish lumë;
bashkë vunë bas
kush të kërcejë më shumë.
Kali mbeti pas,
se dreri ja shkoi,

brodhi sikur fluturoi.
Për këtë shkak,
nga inati, kal' i zi
kërkoj nga një njeri
ndimë që të marrë gjak,
dhe të zënë
bashkë drenë.
Për këtë punë,
kalit i vunë
një fre në gojë.
Njeriu pastaj u nis,
ju hoth kalit mbi kurris,
që ta shpjerë tek të dojë.
Pas dy orë,
drer'i gjorë
përdhe ra,
se u vra.
Kali kur e pa,
ju qas ta shkelmojë
edhe ta mendojë.
Pastaj, njeriut i tha:
«Qënkej trim me të vërtet,
gëzohem fort që të gjeta.
Të lumtë, t'u ngjatë jeta!
Do të shkoj, mbeç me shëndet,
se puna nukë më pret.
— Jo! tha trimi, kam dëshirë
të të marr të të kem unë,
se do të më hysh në punë,
me mua do të shkosh mirë,
duke ngrënë, e duke pirë».
Njeriu, pas këto fjalë

vate ndë shtëpi me kalë.
Kur e lidhi me litar,
tek një grashd, ndë një qilar,
i dha plot elb, kasht'e bar,
kal' i gJORë, kal' i shkretë,
që shiti lirinë vetë
për të ngrën' e për të pirë,
e kupëtoi, për Zonë,
që s'bëri mirë,
po ishte vonë.

Shokë, kjo përallë thotë:
kur duani të kërreni
inatnë, mos e përçbleni
me liri në këtë botë.
Liria, shokë, liria,
s'çmohet dot në këtë jetë!
Na i faltë Perëndia,
e trashëgofshim dhe vetë!

DHELPA DHE NJË SHAT

Njerst' e mëdhenj ¹⁾ shumë herë
mënd ndë kokë nukë kanë,
si pandejnë ca të tjerë:
ndryshe duken, ndryshe janë.
Gomari si sheh gjykon,
po dhelpa që shikon,
i vë re më mirë,

1) njerst' e mëdhenj = këtu ka kuptimin për sundimtarët që shtypin popullin.

i kqyr me dëshirë,
dhe kur kupëton
që janë pa tru,
si një kërcu,
tekdo që vete
thotë me vete
fjalët që tha në një vënd,
kur u gjënd
një shtat, them, ndë një qytet.
Shtati tregonte një mbret. —
Mjeshtri q'ë kishte punuar
ish vërtet për të lëvduar. —
Kur e pa,
dhelpra tha
këto fjalë fort të rënda:
«Koka, për të dukur,
qënka fort e bukur,
po s'paska tru brënda».
Si ky shtat e si kjo kokë
gjënden shumë njers mbi tokë.

UJKU, DHIA DHE KECI

Një dhi plakë gjosë
vate të kullosë
me shoqet e tjera.
Kur dolli nga dera,
e mbylli me kyç në ballë,
duke thënë këto fjalë

tek një keç që kishte pjellë
ndënë shpellë:

«Tejtërkush, përveç se unë,
nukë ka punë këtunë.

Bir, të lutem me dëshirë,
mos hap derën, vështro mirë!

Në do që të jesh i gjallë,
kushdo që të të thërresë

nga jashtë, mos i ep besë
pa ndëgjuar këto fjalë,

bir, më parë:

«Ujkun dreqi do ta marrë».

Këto tha dhia dhe shkoi.

Një ujk fsheur e ndëgjoi

dhe, kur u largua dhia,

u qas ujku te shtëpia

dhe me vrap krisi në portë,

duke thënë me të fortë:

«Ujkun dreqi do ta marrë!»

Dera s'u hap me të parë,¹⁾

si kish egërcira shpresë,

se keci s'i zuri besë.

Shtiu synë në një vërë:

«Kris, i tha, ditën të tërë,

në mos ke, zot, tjetër punë,

po nukë hyn dot këtunë

po s'më tregove përpara

të bardha këmbët e para».

Po kurrë nukë ka dalë

1) me të parë = menjëherë.

një ujk me këmbë të bardhë;
ndaj, kur gjegji këto fjalë,
ujku shkoi nga kish ardhë,
me kokë poshtë, me bisht në shalë.
Sikur ta kishte besuar,
keçi ç'do të kish pësuar,
të kishte dalë në derë
si kishte ujkun dëshirë?
Do të diste keç'i mjerë.

Shokë, kush ruhet dy herë,
shpëton, se ruhet më mirë.

UJKU DHE MËMA ME TË BIRRË

Një bujk, thon' ata q'e dinë,
jashtë fshatit kish shtëpinë,
mbante plot dhi, dhën e shtjerra,
pula, pata, dosa, derra.
Ujku, q'i pa nga një vërë,
priti një ditë të tërë
mos dalë nonjë nga dera,
që të lëshonet ta zërë,
ta marrë ta çopëtojë;
po i vate dëm mundimi,
se s'ju mbarua qëllimi.
Nga ky shkak, u nis të shkojë,
kur, gjegji një çun të qajë.
E ëma, për ta frikuar

i thoshte duke qërtuar:
«Pusho! Ujku të të hajë»!
Pas këto fjalë,
ujku me gas
në der' u qas
si dhe në ballë.
Mbase Zoti ja bën mbarë
të rrëmbejë këtë djalë,
ndë dhëmbë ta ketë,
si tha mëma vetë.
Çuni, duke qarë,
thërret e bërtet,
qan se mos e marrë
ujku plak vërtet,
që ta copëtojë.
E ëma, që ta pushojë,
të birit i thotë
duke fshirë lotë:
«Pusho, bir, s'vjen ujk këtunë,
dhe po të vij', e vras unë».
Kur ndëgjoi gjakëtori
këto fjal', u zëmërua
dhe thosh: «Ç'thotë kshtu kjo grua?
Vallë për cinë¹⁾ më mori,
që guxon e qesh me mua?
Të tjera fjalë
thoshte në ballë,
dhe tani thotë të tjera!
Duket s'më njëh mirë...!
Në pafsha të birrë
të dalë nga dera,

1) për cinë = për cilin.

di se ç'do t'i bëj.
Do të shojë, do të shojë,
për emër të Pernëdisë!»
I mbeti fjala ndë gojë,
se u hap der' e shtëpisë
dhe dolli bujku
të vejë nd'arë,
të mbjellë farë.
Kur e pa, ujku
u fsheh te muri.
Një qen i fortë
dolli në portë,
në zverk e zuri.
Burrat dhe gratë,
kush me sëpatë,
kush me lopatë,
të gjithë vanë
te ujku pranë,
muarr e dhanë,
sa deshn' e rranë,
në shesh e lanë,
pastaj i thanë:
«Ç'deshe këtunë?»
Ujku tha: «Unë
s'punoj me dhunë.
Ç'kin me mua?
Për këtë punë
ka faj kjo grua.
Kshtu dhe kshtu ngjau
çuni kur qau.
— Të marrtë nëma ¹⁾

1) të marrtë nëma = të zëntë mallkimi.

i thotë mëma.
Të marrtë djalli,
thell' e më thellë!
Ç'të bëri djali?
Nuk e kam pjellë,
ta çash të gjallë?»
Me këto fjalë,
u ngre dhe bujku,
thikën rrëmbeu,
vate te ujku,
kokën i preu!
Dhe një fshatar,
veç nga të tjerë,
e merr e mvar
me një litar
sipër në derë,
duke shkruar këto fjalë
ujkut në ballë:
«Ujk, paç uratë,
jeta t'u ngjatë,
mos beso gratë
mëma kur janë;
djemt i qërtojnë
dhe i frikojnë,
që të pushojnë
kur zën' e qanë».

NJË FJAL' E SOKRATIT 1)

Sokrati plak ndë Pire 2)
bënte një shtëpi të re.
Kur u sos shtëpia,
gjithë njerëzia
vanë ta urojnë
dhe ta ngjatjetojnë,
po shtëpia s'u pëlqeu.
Thanë: «Mjeshtri të gënjeu,
sa për një njeri si ti
është e vogël kjo shtëpi,
s'është as e gjër' e lartë».
Për të shuar këtë qartë,
dhe më tepër nga inati,
hidhet e thotë Sokrati:
«Kshtu si është bërë
e vogël shtëpia,
dhëntë Perëndia
të mbushet e tërë
me miq të vërtetë!»
Sokrati me këtë fjalë
tha mirë: në këtë jetë,
miqtë janë fort të rrallë.

1) Sokrati = filosof i famshëm i Greqisë së vjetër.

2) Pire = një nga limanet kryesorë të Greqisë.

PLAKU DHE TË BIJT E VET

Na ka thënë Perëndia,
bashkimi dhe dashuria
madhojn' e shtojnë fuqinë.

Gjithë e dinë
këtë fjalë.

Një përallë
do t'u them, se kam shkak.

Ish një plak,
kish trim djem.

Pa vdekur i thirri,
se i doj me ashkë.¹⁾

«U lutem, u tha, të mirri
këto shufra lidhur bashkë,
dhe lakëmoni
t'i çopëtoni». ²⁾

Një nga një, djemtë rrëmbyen
shufrat që kish plaku pranë,
muar e dhanë,
po nuk i thyen;

me inat në shesh i vunë.
Plaku hidhet e u thotë:

«S'qenki të zotë
për këtë punë!

Sillni këtunë
t'i thyej unë».

Të tre djemtë q'e dëgjuan,
qeshnë se nuk e besuan,
dhe nukë pandyen kurrë

1) ashkë = zjarr.

2) çopëtoni = thyeni.

një burrë plak i sëmurë
më tepër fuqi të ketë
nga tre vetë.

Po Plaku nuk i gënjeu:
i ndau shufrat në ballë,
pastaj një nga një i theu,
duke thënë këto fjalë,
që t'i mbaronet qëllimi:
«Djem, fuqin' e bën bashkimi,
ndaj duhet të mos përtoni
në këtë botë të rroni
gjithë bashk' e të pandarë
që t'u vejë puna mbarë.
Kini që të tre një gjak,
ini vëllezër e miq».
Këto fjalë tha ky plak,
pastaj mbylli syt' e vdiq.
Djemt zotuan
gjënë që pati.¹⁾
Armiqt u shtuan
kur vdiq i jati,
gjith i trazuan,
ca nga inati,
ca nga nakari, —
i djegtë zjarri!
Kot u munduan,
se dëm s'u bënë,
djemt u bashkuan,
shpëtuan gjënë.
po nukë shkuan
dy vjet; harruan

1) Djemt zotuan = djemt trashiguan gjënë qi i la plaku.

fjalët q'u kish thënë plaku.
I kishte bashkuar gjaku,
po interesat i ndanë,
dhe vëllezërin' e lanë,
me njeri-tjetrin u zunë.
Armiq, gjitonë,
u gjenë kohnë,
në gjyq i shpunë.
Të tre vëllezërit u prishnë,
se humbnë gjënë që kishnë,
nga nakari, nga inati.
Kujtuan, po ish mënuar,
shufrat q'u kishte treguar
për shëmbëll, kur vdiq i jati.

SYR' I ZOTIT TË SHTËPISË.

Ndë një qilar me qe plot,
u fut një drë të shpëtojë,
po qet' i thanë të shkojë,
se shpëtim nukë gjen dot.
«Shokë, mos më kallëzoni,
tha drër' i mjerë,
pa t'u tregoj të kulloni¹⁾
një vënd të gjërë,
me bar të njom' e të gjallë».
Gjithë qetë dhanë fjalë
të mos tregojnë
kur ta kërkojnë.

1) të kulloni = të kullosni.

Drëri q'atë çast
u fshe ndënë grasht,
ndaj, shërbëtorët kur vanë
atë mbrëma ndër qilar,
për të shpurë qevet bar,
drënë me brirë s'e panë;
dhe kur duall, drër' i shkretë
ngjatjetoj me gas qetë.

Ahere u hoth një ka,
duke përtypur i tha:

«Për emër të Perëndisë,
nga rreziku s'ke dhe dalë,
se vjen i zot' i shtëpisë
që ka njëqind sy në ballë».

Pa mbaruar këto fjalë,
u hap dera për së dyti,
i zot' i shtëpisë ryti ¹⁾

duke sharë
shërbëtorë:

«Pse s'paski fshirë qilarë
dhe hoborrë?

U vjen rëndë

për çdo punë!

Kjo parmendë

ç'do këtunë?

S'grihet vetë

ky samar!

Shiko! qetë

s'kanë bar!»

Këto foli ky njeri.

Duke parë më çdo anë,

1) ryti = hyri.

gjetei drënë ndë një bri:
gjithë ç'qenë ndë shtëpi,
ndë qilar u ngren' e vanë;
zunë drën' e çopëtuan,
e poqnë, në hell e shkuan,
hëngër e pin' e kënduan
me të tjerë miq që ftuan.
E drejtë fjala që thonë:
gjithë sytë nukë shohnë
në këtë botë të marrë.
po syr'i zotit shtëpisë
edhe syr'i dashurisë
nukë lenë gjë pa parë.

PESHKU I VOGËL DHE PESHKËTORI ¹⁾

Një peshk i vogël ndë det,
kur i ep Zoti shëndet,
madhonet dhe shtonet;
po ndë duar kur t'u bjerë,
mos e lini,
se s'e zini
tjatër herë.

Një njeri zuri ndë lumë
një peshk, po të vogël shumë.
«Ç'më do? thirri peshkë, i mjerë,
Të më hash? Për këtë punë
duhen një qind peshq sa unë.

1) peshkëtori = peshkatari.

Sot është dëm që të vritem,
lëshomë prapë të rritem
dhe të më zëç kur të mahem,
se kshtu si jam nukë hahem.
— Je si je, tha peshkëtori,
të zura, dreqi të mori!
Sot që të kam s'të lëshoj,
nesër ku të të kërkoj?
Kush e di si gjan?»

Një peshk ndë tigan,
shokë, vjen më shumë
se një mijë peshq në lumë.

VESSHËT E LJEPURIT

Një luan ndë një vërri,
për qime shpëtoi:
një kafshë me bri
desh e copëtoi.
Të mos ndodhij tjetër herë,
luani me gjoks të gjërë
ndoqi në një shkretëtirë
të tëra kafshët me brirë.
Deshtë, cjeptë, dhënt e dhitë,
drerët, qetë, q'atë ditë,
nga frika iknë të tërë,
u futnë vërë mbë vërë.
Me vrap, një ljepur i ngratë,
kur ndëgjoi këtë punë,

kujtoi veshët e gjatë
dhe tha: «Ç'bëj që rri këtunë?
Veshët që kam, s'më shpëtojnë,
se për brirë do të shkojnë!
— Ljepur, kokëkungull,
i thotë një brumbull,
veshët brirë s'janë!
— Kush e bind, birr-o, luanë?
tha ljepuri me mënd trumbull.
N'i marrtë për brirë,
fjalët i merr era...
Po t'iki më mirë
si kafshët e tjera».

DHELPRA PA BISHT

Një dhelper me bisht të prerë,
u tha shoqevet një herë:
«Shoqe, vërtet besa-besë,
ç'na duhet bishti që kemi,
që na varet pas si fshesë?
Ta presëm të gjithë ç'jemi,
për ne bishti është i tepër.
— Fortmirë, thotë një dhelper,
mëndjen tënde kam dhe unë,
kurrë bishtin s'e bëj has; ¹⁾
po, pa bër këtë punë,
të lutem ktheu nga pas,
të të shikojmë të tërë

1) s'e bëj has = s'e kam qejf.

pastaj shomë ç'duhet bërë
me bisht që kemi ndë shalë».
Kur ndëgjuan këto fjalë,
gjithë dhelptrat zun'e qeshnë,
duke treguar me gisht
dhelpren që nukë kish bisht;
dhe nukë deshnë
dhelptrat e tjera
të jenë si kjo bishtprera.

KALI DHE UJKU

Një kalë
kish dalë
vetëm, një ditë në maj,
dhe kullose në një shesh.
Një ujk që donte ta haj,
thoshte: «T'ishte dash me lesh,
do ta çqepij më kollaj.
Me dhelpërira, të shomë,
mbase ha sot mish të njomë...
Mirëdita, zoti kalë,
tha gjakëtori në ballë.
Vetëm s'të kam parë kurrë,
mos je vërtet i sëmurë?
Mos ta punuan me dhunë?
Folë, mos u tremb nga unë,
se jam shëronjës për Zonë!
Pyet ata që më njonë,
gjithë smundjet i shëroj.

— Vërtet, tha kali, që sot
më dhemb këmba, s'eci dot.
— Pa dale të ta shikoj»,
tha gjakëtori me gas.
Kali, kur e pa q'u qas,
ngriti këmbën e u kthye,
i ra me një shkelm ndër krye,
i theu dhëmb'e dhëmballë.
«Fortmirë, t'u ngjatë jeta,
e kërkova dhe e gjeta!»
tha ujku me bisht ndër shalë,
duke larguar me vrap.
«Zoti më bëri kasap,
ç'desha të shkoj për xhara? 1)
Bëri mirë që më ra».

MAL' I MBARSUR

Një mal, thonë, qe me barrë!
Ditën që do të shpëtonte,
thërrit, bërtit e rënkonte,
ulërinte duke qarë.
Për këtë shkak, çdo njeri
pandeu me të vërtet'
se do të pill një qytet,
po mali polli një mi!...

1) për xhara = për mjek kirurg.

Kjo përrallë më përmend
ca shkronjëtorë pa mënd,
që na mburren kurdoherë
dhe thonë që s'kanë shokë.
Ç'del nga këto kokë?
Erë, vetëm erë...

FATI DHE NJË ÇUN

Buzë pusit, një djalosh
ish shtritur, flinte pa ndrim!
Nukë do të kish shpëtim,
do të kish rënë përposh.
Shkoi fati, zgjoi çunë:
«Bir, i tha, në do të rritesh,
të mos vish të flesh këtunë,
se do biesh të vritesh.
Këtë gjëmë nuk e dua,
se fajne do ta kesh vetë,
po do të ma shtien mua,
si çdo gjë në këtë jetë».
Jemi të marrë?
Jemi gomarë?
Fatne ngarkojmë.

Për çdo punë që punojmë,
kur s'na del mbarë,
për të ligat që na ngajjnë,
në këtë botë,
gjithëkush thotë:
fati ka fajne.

NJË LUAN NË LUFTE

Një ditë, një luan trim
bëhej gati të luftojë:
grishi ¹⁾ për këtë qëllim
gjithë kafshët, që t'i msojë
në këtë luftë t'i ndinë,
me sa mundin e sa dinë.
Sofra kur u shtrua
për të ngrënë drekë,
elefanti u zotua
të mbarij topa, dyfekë;
ariu dha fjalë
të sulet në ballë
me këmb'e me duar;
armiknë duke përgjuar,
dhelpra t'i bëjë llagëme
me ca gjepura, të rrëme;
majmuni siç ka zakon,
me ca lodra që punon,
te armiku do të vejë
ta zbavitij, ta gënjejë.
Një nga shokët del e thotë:
«Ç'duan gomarët këtunë?
Nukë na hyjnë në punë,
se nukë janë të zotë.
Dhe ljepurat frikamanë,
nukë bën t'i kemi pranë.
Ndiqni, mos i mbani.
— Jo, jo, tha luani,
kërkush mos i ngasë,

1) grishi = e ftoi.

se të tër' i dua
të vinë për mua.
Gomari kur të pëllasë,
për trumbetë do të shkojë,
armiqtë do t'i frikojë;
dhe ljepurin do ta mar,
se di të këcejë
andej e këtejë,
do ta kem për lajmëtar».

Kurdoherë, në çdo vënd,
Një mbret i urtë, me mënd,
po të dij të gjykojë,
për çdo njeri ka nevojë.

GJELI, MAÇOKU DHE MIU

Një mi vogëlam, ¹⁾ i ri,
për të shëtitur kish dalë;
kur u kthye në shtëpi,
i tha s'ëmës këto fjalë:
«Dolla, brodha nëpër ara
dhe nëpër fusha të gjëra,
dhe gjeta përpara
dy kafshë të tjera.
Një ish bukurosh,
i urt'e i mirë,
tjetri, një kokosh,

1) vogëlam = i vogël.

dukej egërcirë.
Kurrë s'keshë parë
të tillë jezit: 1)
thërrit e bërtit,
sikur ish i marrë.
Mbi kokë të thatë,
kish një copë mish,
dhe një bisht të gjatë.
Hapte, mbyllte kratë,
që kishnë plot pëndë;
ndë një vënd s'qëndronte,
tundte gjithë vëndë
kur zinte këndonte
me një zë të trashë.
Kur e pashë, lashë
mënç, dhe me vrap ika
andejë nga frika,
me këmbë e me duar,
duke mallëkuar
këtë drej të lik,
që s'më la të bëhem mik
sot me kafshën tjatër.
M'u duk i but'e besnik,
kish si neve këmbë katër,
dy sy të qelqtë, plot dritë;
nga veshët dhe nga turitë,
m'u duk si nga fara jonë.
Dhe fort i dashur, për Zonë.
Qëndronte përdhe i qetë.
Nga mënyra që shikonte,

1) jezit = njeri i pabesë.

m'u duk sikur dëshëronte
për mik e shok të më ketë.
Mjerisht, nuk u afëruash,
se më trëmbi kafsh' e parë.
— Ndëgjo, bir, ashtu më rruash,
i tha nëna duke qarë.
Kafsha që do të kesh shok,
për minjt është armik,
i egër, i lik,
dhe quhet maçok.
Është zëmërgurtë,
po shtiret i urtë,
i mjer' e i gjorë,
sa të na vërë ndë dorë.
Në pyet për gjelë,
që more për shtasë,
jo vetëm s'mund të na vrasë,
po na hyn edhe ndë gjellë.
Për kundrë, maç-ziu,
bir, ha mish nga miu,
s'ka tjetër uzdaj' e shpresë».

Fytyra nukë ka besë:
njerstë që shikoni,
s'duet t'i gjykoni
sot pas fytyrës që kanë,
se si duken nuk janë.

DHELPRÀ, MAJMUNI DHE KAFSHËT

Vdiq një luan mbret i vjetër,
Shtasat kur e msuan,
ndë qytet qëndruan
që të zgjedhin një mbret tjetër,
me fuqi të Perëndisë.
Të tërë, për këtë punë,
me radhë muar e vunë
kuratorën e mbretërisë,
po asnjë s'u gjend
ndë gjithë atë vënd
që t'i vejë mirë;
ca kishnë kryet me brirë;
midis të shokëvet tjerë,
ca kishnë kokën të gjërë,
ca të vogël si një dardhë.
Majmuni, kur gjeti radhë,
ngjati pak dorën,
mori kurorën,
në qaf'e shkoi,
e vu në kokë:
me ca lodra që tregoi,
pëlqeu në gjithë shokë;
dhe për këtë shkak, majmunë
për mbret e vunë.
Të tërë ç'qenë,
më këmb' u ngrënë
për të ngjatjetuar mbrenë.
Dhelpra, që s'e deshi,
ndënë buzë qeshi
dhe i tha mbretit në vesh:

«Zot, kam parë ndë një shesh,
tek një leth me bar,
një poçe me ar.
Tekdo që të jetë,
një mbret ka nevojë
plot pare të ketë,
që të mbretërojë.
Majmuni me gas
mori dhelprën pas
dhe vate të shojë.
Ndë leth kur u qas,
majmuni sultan ¹⁾
ra ndë një dhokan,
zënur nga këmb'e nga duar.
Dhelpr' e mallëkuar
hidhet e i thotë:
«Kur nukë di të punosh,
qysh guxon të mbretërosh,
ti kodosh, ndë këtë botë?»
Këto fjalë kur ndëgjuan,
gjithë kafshët zun'e qeshnë,
majmunë për mbret s'e deshnë
dhe nga froni e rrëzuan,
se kupëtuan
dhelpra me shokë,
që kuror'e mbretërisë
s'është bërë për çdo kokë.

Për emër të Perëndisë,
mos harroni këto fjalë:
mbretret e mirë janë të rrallë.

1) majmuni sultan = majmuni mbret.

FSHATARI DHE GJARPËRI

Një vit në janar,
dolli një fshatar
jashtë nëpër ara,
kur gjeti përpara,
mbuluar me borë,
një gjarpër të mpirë,
të mbledhur, të ngrirë.
E mori ndë dorë,
ndë shtëpi e shpuri
dhe pranë zjarrit e vuri.
Gjarpëri kur u ngro, u zgjua,
u droth e u rrotullua,
ngriti kryet, u lëshua
me qëllim për të kafshuar
fshatarë q'ë kish shpëtuar!
«Unë, tha fshatar' i mjerë,
të prura këtu të ngrova,
sot nga vdekja të shpëtova,
dhe ti do të më lëç vrerë!
Qënkej i lik sa s'ke shokë!»
Q' atë çast, fshatar' i ngratë,
me vrap mori një sëpatë
dhe i ra gjarpërit në kokë.

Njerst' e poshtër e të liq
nukë bëhen kurrë miq.

LUANI I SËMURË DHE DHELPA

Rrëzë malit, tek një shpellë,
ndë një vrimë mjaft të thellë
dhe të gjërë si një furrë,
një luan dërgjej sëmurë.

Kur e msuan,
kur ndëgjuan,
të tëra kafshët u ngrenë,
vanë të shikojnë mbrenë.
Nga gjithë kafshët e tjera,
dhelpa qëndroi te dera,
duke thënë këto fjale:
«Këtu mbrënda hyjnë plot,
po unë s'kandisem dot,
se s'shoh asnjë që të dalë».

KAFSHËT DHE MURTAJA

Gjithë kafshët u sëmurë,
nga murtaja ¹⁾ desh u shuan.
Sa të këqia që vuan!
S'hanin dot as pinin kurrë.
Kurkush pa lëngatë s'mbeti,
s'u vinte mbarë shëndeti.
Nga ky shkak, luani, mbreti,
mblodhi kafshët të mendojnë

1) murtaja = kolera.

si të sillen, ç'të punojnë,
nga murtaja të shpëtojnë.
«Shokë, tha, jemi të tërë
të liq, fajtor'e të mjerë;
të ligat që kemi bërë,
zëmëruan Jupiterë.

Po të mos i shkojë vreri, ¹⁾
murtaja që na ka zënë
kurrë s'ka për të na lënë;
duhet' zbutur Jupiteri,
për këtë qëllim e shpresë,
një prej nesh duhet të vdesë,
të paguaj' për të tërë
fajet që kemi bërë;
duhet të bëhet theror
kush është m'i madh fajtor.
Ndaj, u lutem, gjithë ç'janë
të themi fajet që kemi.

Vetë s'le gjësend pa thënë;
shumë desh' e cjep' kam zënë,
i kam çar' e i kam ngrënë;
shumë herë, për Perëndinë,
kam grabitur dhe barinë,
kur më ka rënë në duar.

— Shumë mirë ke punuar,
tha dhelpira. Ç'është një dash?
I bën nder kur zë ta hash.
Sa për barinë, mos qaj,
kur e hëngre s'bëre faj.
Rroftë kushdo që ta vrasë,
është m'i keq nga çdo shtasë!»

1) vreri = këtu ka kuptimin zëmërimi.

Kshtu tha dhelpira për luanë,
dhe të tjerët kështu thanë.
Pas luanit, foli thiu,
tigrin, ujku dhe ariu;
po dhe këta gjakëtorë
shkuan vërtet për shëntorë;
nga frika, kafshët e tjera
t'i kundërshtonin s'guxuan,
që kishin ngrënë plot shtjerra.
Erdhi fjala te gomari:
«Një ditë, tha, në behar,
hyra ndë një shesh me bar!
Dreqi, uria dhe bari
më shtynë në këtë punë,
se nuk është pun'e mirë.»
Gjithë shtasat zun'e thirrë:
S'bëhet dot m'e madhe dhunë,
të hash bar ndë shesh të huaj!
Zot na ruaj! Zot na ruaj!
I tillë faj nukë ndjehet,
vetëm me vdekij përçblehet!»
Veshgjatit s'i mbeti shpresë,
u gjykua që të vdesë.
Me faj, pa faj, shpëtim s'ke,
trim i fortë në mos je.

DORËSHTRËNGUARI

Shumë njers gjënë s'e hanë,
se i ha gjëri ¹⁾ që kanë.
Për paratë rrojnë,
para dëshërojnë,
dhe presën
të vdesën
që t'i trashëgojnë.

Ish një plak i mallëkuar,
shumë para kish fituar,
po ishte dorështrënguar,
i pangopur: domethënë,
mbante fshehur gjithë gjënë.
Ndë një vrim'e kishte vënë,
tek një pyll, ndënë lofatë. ²⁾
Atje vinte dit'e natë
dhe numuronte paratë,
duke qeshur e plot gas.
Një fshatar q'e kish përgjuar,
qetazi, pa kupëtuar,
e mori një ditë pas.
Plaku, pa ndrim, kur qëndroi,
ngriti një gur dhe zbuloi
lirat. Kur i numuroi,
të tjera lira lëshoi,
pastaj vrimën e mbuloi,
me rëmbim u ngre dhe shkoi.
Fshatari q'e kishte parë,

1) gjëri = pasurija

2) lofata = pemë e egër që i çelë lulet tufa tufa ngjyrë tran-
dafili.

kupëtoi se ç'kish ngjarë
dhe me vrap u qas te vëra,
rërmbëu lirat të tëra.
Të nesërmen, nukë priti,
vate në pyll plak'i ngratë,
ulëriti, thirri, briti,
se nukë gjeti paratë.
«Pse bërtet e qan me lot?
tha një bari q'u ndoeth pranë.
— Më kanë vjedhur paranë,
thotë plaku, s'e gjej dot!
Ma kanë marrë me dhunë!
— Ç'para, ku i kishe vënë?
— Ndë këtë vrimë këtëunë.
— Këtu? Fortmirë ta bënë!
Ndë shtëpi pse nuk i mbaje,
vetë t'i prishje, t'i haje?
— Të haje parat' e mia?
Mos e dhëntë Perëndia!
Mik, paratë s'janë gurë,
ndaj nuk i trazoje kurrë.
— Kur s'i trazoje
kurrë, ç'i doje?
Mik, sado qave
ditën të tërë,
tani, ndë vënd të parave,
fut një gur ndë këtë vërë!»

GRUAJA QË SHET QUMËSHT

Zonja Peretë,
grua me besë,
një ditë vetë —
dolli të shesë
qumësht në treg.
Duke shkuar brek më brek,
vetëm e pa shokë,
me dori ¹⁾ në kokë,
thosh me vetëhe:
«Me para që do të marr,
do blej një qind koqe ve,
që të kem këtë behar
zoq e pula plot.
Nukë do t'i ther,
do t'i shes ngjer mot,
që të blej një derr,
ta rrit e ta maj
dhe ta shes. Pastaj,
me para që do të kem,
do blej një lop'e një dem,
dhe të dal t'i kullos vetë!»
Nga gazi, zonja Peretë
u hodh ahëre përpyetë:
doria që kish mbi kokë
plot me qumësht, ra ndë tokë:
në çast u bë çopa-çopa.
Vate demi, vate lopa,
derri dhe pulat e shkreta,

1) dori = enë.

i mori dreqi të tërë!
Mbeti në diell Pereta
me ëndërat që kish bërë...¹⁾

DY KOKOSHË ²⁾

Dy kokoshë rronin
si miq dhe këndonin
sipër tek një kulë,
ku kishin shtëpinë;
kur panë një pulë,
prishnë miqësinë.
Shokë, dashuria
punon të këqia:
Tria, thonë, Tria ³⁾
u prish nga ky shkak
dhe u mbyt me gjak,
si thotë një plak.
Kokoshët qërtuan
pa nonjë nevojë,
për pulën lëftuan
kush ta trashëgojë.
Nga këta kokoshë,
kush ish m'i shëndoshë
luftën e fitoi,
me pulën qëndroi,
zuri dhe këndoi.

1) është shkurtuar.

2) dy kokoshë = dy gjela.

3) Tria, Troja.

Atje tek këndonte
dhe vedin lëvdonte,
një shkab' e ndëgjoj,
u sul e rrëmbeu
dhe me thonj e çqeu.
Ahere, me gas,
kokoshi q'u mund
te pûla u qas,
u tund e u shkund,
u kënaq te kula...
Se fjalët i shkuan,
dhe ju afëruan, plot të tjera pûla. 1)

GOMARI DHE QENI

Ndë rrezik e ndë nevojë,
shoku shoknë ta ndihmojë.

Një trim udhëtar
hipur mbi gomar
vinte ndë pazar
dhe qeni me gas
e kish marrë pas.
dhe me lule shumë,
Ndë një shesh me bar
dhe me lule shumë,
zbret udhëtari
dhe bie ndë gjumë.
Ahere gomari

1) është shkurtuar.

qëndroi te sheshi,
hëngri bar sa deshi;
s'pyetnë për qënë,
që mbeti pa ngrënë:
«Shok, tha qën' i mjerë,
ti dhe Perëndia!
Vdiqa nga uria!
Bjerë ndë shesh, bjerë,
pak bukë të marr,
që ke mbi samar,
se s'kam ngrënë sot.
— Dale, tha veshgjati,
të zgjohet im zot».
Qëni, nga inati,
po qante me lot,
se s'duronte dot,
dhe për këtë shkak
u shtri ndënë hie.
Ahere për pak,
del nga një korie
nj' ujk i math si ka.
Kur e pa gomari pranë,
nga frika veshët i ranë
dhe qënit i tha:
«Ngreu të më ruash,
të lutem, o mik,
se jam ndë rrezik!
— Thirrë sa të duash,
tha qëni, s'los dot.
Prit ashtu, më rruash,
të zgjohet im zot.
Duhet të durosh:

nukë ka dyshim
që do të shpëtosh,
se je shumë trim,
nukë ke të sharë,
dhe s'ke nevojë për mua».
Atë çast u afërua
ujku dhe çqeu gomarë.

Këtë fjalë mos harroni:
shoku shoknë të ndihmoni,
se si bëni
do të gjeni.

DITURIA

Ndë një katund, dy fshatarë
kishnë të dhën' e të marre
dhe një dit' u zunë
bashkë për një punë.
Njeri nga këta
kishte dituri,
tjetri kish para
sa s'kishte njeri,
dhe për këtë shkak
donte të kish hak.
«Jam i pasur, unë!
thoshte për çdo punë.
Njerstë më ndëgjojnë
dhe më ngjatjetojnë,
bota më nderon
dhe fjala më shkon.

Ty kush të peshon?
Kush e nderon vjershëtorë?
Thonë që je shumë i msuar,
na çan kokën duke shkruar
vjersha, dhe duke kënduar
malet me tëborë
dhe «Baba Tomorrë». 1)
Po vjershat që shkruan,
kurkush s't'i paguan.
Je xveshur, i gjorë,
jam veshur me ar;
kam kalë me shalë;
ti dimr' e behar
ke petka një palë,
dhe vdes nga uria.
Të rruatë dituria,
dreqi që të mori!»
Këto dhe të tjera,
fjal' i mori era,
se pushoi vjershtëori.
Po ç'të thosh, i gjori?
Ish vërtet me mënd,
nukë shante dot.
Nukë kish shkuar një mot,
u ndez lufta n'atë vënd:
u prish fshati anëmbanë,
shtëpit' u dogjën dhe ranë
nga luft' e plasur!
Për këtë shkak,
fshatar i pasur

1) «Baba Tomorri: = titulli i veprës më të mirë të Çajupit.

mbeti çipllak, ¹⁾
me shkronjëtor' u bë shok!
Ahere, që të dy tok
nga katundi u larguan.
Tekdo që van' e qëndruan.
nierin' e msuar
gjith e nderuan
nga vjershat që kishte shkruar.
tietrin, kurkush s'desh ta shojë.
s'i foli njeri me gojë.
Viershëtorë gjith e ftuan
për të ngrën' e për të mirë.

Le të thonë si të duan,
dituria është' e mirë.

DY PLLUMBA

Dy pllumba duen me ashkë, ²⁾
dit' e natë rrinë bashkë.
Mjerisht, një pllumb nga këta
një ditë shokut i tha:
«Do t'iki, mbec me shëndet,
do të vete ndë kurbet,
të shikoj ç'bëhet ndë botë».
Duke qarë, tjetri thotë:

1) çipllak = lakuriq.
2) ashkë = me zjarr.

«Mik, në më do si të dua,
të lutem të rrish me mua!
Rri, o mik, këtu të rrimë,
bashkë të ham' e të pimë;
mos le vendë tek ke lerë,
udha ka rrezike shumë;
kur të fryj' e kur të bjerë,
për ty do të rri pa gjumë!»
Pas këto fjalë që thanë,
u pushtuan dhe u ndanë.
Udhëtari pllumb, pa grua,
nga folea u largua
ndë mëngjes, pa gdhirë mirë.
Pas pak, qiejt u trazuan,
ret' e zeza i mbuluan;
binte shi dhe breshëri.
Udhëtari, lis më lis,
pandente se do të vdis,
se tekdo që vinte rrinte,
breshërira e godinte.
Pak nga pak shiu pushoi,
udhëtari fluturoi,
po nga rreziku s'shpëtoi:
një ngjeraqin' e kish parë,
u lëshua që ta marrë,
me thoj që ka si kërrabë.
Atë çast u ndodh një shkanë,
me ngjeraqinën u zunë.
Pllumbi, kur pa këtë punë,
me vrap u fshe tek një mur.
Një çun e godit me gur!

Udhëtari duke qarë,
gjysm' i vdekur e i çalë,
u kthe që ditën e parë
ndë fole tek ish në ballë. 1)

NGJERAQINA 2) DHE BILBILI

Një ditë ndë prill,
një ngjeraqin' e pabesë
zuri një bilbil.
Ky, kur pa që do të vdesë,
tha: «Zonjë, ç'kërkon nga unë?
Misht e mi s'të hyn në punë.
Lemë sot të rroj
dhe të të këndo
një këngë të mirë
që kam bërë vetë,
këngë mbreti të vërtetë».
Ngjeraqina, egërcirë,
i tha: «Pa ngrën' e pa pirë,
këngët nuk i dua;
muzika s'është për mua,
mik, pse të të qesh?
Uria s'ka vesh».

1) është shkurtuar.

1) gjeraqina = petriti, njëlloj zogu.